

LAJMËTARI

I BERATIT

Kryeredaktor:
Agim Mehqemeja
Reportere:
Eriola Azizolli
Dizajn:
Anxhela Bibo.
Menazhimi:
Yzedin Hima
Botues:
Lajmëtari sh.p.k.

Viti I, Nr.19 E përjavshme e pavarur

E mërkurë, 12 nëntor 2003

Çmimi 20 lekë

Adresa: Lagjja "Dëshmorët e Kombit", pranë shtypshkronjës "Lirsan Ekspres". Tel: + 069 2586803

Nesër nis punën Bashkia e re e Beratit

KUNDËR RRJEDHËS

Sami Starova

Shpërfillja ndaj të drejtave të fëmijëve është e tejskajshme

Faqe 2

Ali Lybeshari

PJESEZ NGA
MASKARADA
ELEKTORALE NE
BERAT

Faqe 3

Eriola Azizolli

Në pritje të kreut të ri të bashkisë

Faqe 4

STRES

Bujar Orizaj

Përse duhet të dënohemi kolektivisht?!

Faqe 5

Yzedin Hima

Emocione nga Berati

Faqe 6

Namik Gjoni

Ismail Qemali, burri që ngriti flamurin kombëtar

Faqe 7

Agim Mehqemeja

Xhemalie Nova

Në njëvjetorin e grupit artistik "Berati"

Faqe 8

Vasillaq Kumani

Tregim

Plak ashik edhe topall

Faqe 9

Namik Selmani

Kuzhinieri që ka ushqyer Presidentët

Faqe 10

Vlash Pambuku

Në vend të një interviste

me sportistin Emir Qafa

Faqe 12

Të enjten, më 13 nëntor, në orën 9.00, bëhet konstituimi i këshillit bashkiak. Niko Mata i dorëzon shiritin me ngjyrat kombëtare kryetarit të Bashkisë, Fadil Nasufit. Socialistët Vladimir Kumaraku dhe Ymer Kordha janë kandidatët për kryetarë të këshillit bashkiak. PD nuk do të vendosë kandidaturë, do të votojë kundër.



Bashkia e Beratit

Bashkia e Re, a do të jetë shtëpia e qytetarëve?

Nesër fillon punën Bashkia e Re e Beratit. Natyrisht, është një ngjarje e rëndësishme në jetën e qytetit.

Një nga premtimet e kryetarit të Bashkisë z.Fadil Nasufi, gjatë fushatës qe: "Bashkia e Beratit nën drejtimin tim do të jetë shtëpia e të gjithë qytetarëve".

Një premtim impresionues. Tani qytetarët do të presin realizimin e këtij premtimi që do të thotë: "Bashkia e Beratit do t'u shërbejë pa dallim të gjithë banorëve, administrata e saj do të përfaqësojë nivelin profesional, kulturor, etik e moral të këtij qyteti, institucionet e vdekura kulturore do të gjallërohen nëpërmjet një reformimi e modernizimi për t'iu përgjigjur kulturës së shënuar të këtij qyteti dhe sidomos kërkesave të rinjve për më shumë argëtim, shfaqje të kulturuar, promovim të kulturës së lashtë dhe asaj të re, mbështetje për artistët që numërohen me gishtat e njerës dorë në këtë qytet, krijimin e këshillit të kulturës së Bashkisë që nuk ekziston, përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, mbrojtjen e tyre nga gogoli i zi që e ka emrin KESH, lufta e përditshme kundër varfërisë etj.


Lajmëtari uron për fillimin e punës këshillin bashkiak dhe kryetarin e ri të Bashkisë së Beratit.

Lajmëtari

Si mund të mbronni automjetet tuaja?

Përdorni vajra të cilësisë së lartë

TEXACO



Goma të ndryshme

KËTU DO TË GJENI me shumicë dhe pakicë:



Shell

ALDOM

FILTRA



Bateri të cilësisë së lartë

Tek Parku i Urës Vajgurore
Adresa: Përballë Western Union

Administrator: Edison Fitim Beshiri
Tel: 0682235888; 0692052522

KUNDËR RRJEDHËS

Shpërfillja ndaj të drejtave të fëmijëve është e tejskajshme

Ç'farë kënaqësie ndjen Nano, kur salla e mbushur me fëmijë thëret: "Rroftë Nano, vdekje Berishës, rrofshin socialistët, vdekje demokratëve".

Po ashtu, çfarë ndien Berisha, kur, po në këto salla, hidhen parulla në adresë të Nanos dhe socialistëve. Kjo llogjikë, sa paradokse aq dhe fatale, të çon në dëshirën për zhdukjen e gjithë Shqipërisë...

Në Shqipëri ndodhin shumë çudira, që për autorshpikës kanë politikanët. Shpikja e fundit, e cila kalon në çmenduri, është ajo e futjes së fëmijëve nëpër kampe politike, duke krijuar platforma konfliktuale.

Çdo njeri normal, do të alarmohet kur shikon politikanët tanë plot gaz në mes fëmijësh dhe parullave, të regjistruara e të diktura nga më të mëdhenjtë. Skenat janë të shumta. Kujtoni skenën e hapjes së fushatës së kryetarit të bashkisë së Tiranës, z. Edi Rama. Ai u prezantua i vendosur në qendër të çadrës, në mes dy fëmijëve të vegjël. Njëpërjet fjalëve të kryetarit informohemi se këta dy fëmijë janë me banim jashtë Shqipërisë. Çadrën politike e kemi parë të tejmbushet me fëmijë, sikur ajo të ishte një çadër cirku ose një kënd lojërash, aq të domosdoshëm për fëmijët.

Kryetari i Bashkisë, që e ka për detyrë të kujdeset për këta fëmijë, të krijojë kushte për të luajtur, për të mësuar, për ndriçim e ujë, për të siguruar ngrohtësinë në mjediset shkollore gjatë dimrit, pse jo dhe ushqimin, bën marrëzira që do të kujtohen nëpër dekada.

Rikujtoni hapjen e fushatës së socialistëve dhe demokratëve në Sallën e Kongreseve. Kryetari i bashkisë së Tiranës shfaqet

mbi podium mes fëmijësh. Kur ai paraqiste platformën, ku futej dhe arsimit, fëmijët mbrapa tij kishin dëshirë të luanin. Në sallë, Kryeministri, midis fëmijësh dhe parullave. Çdo parrullë e hedhur nga fëmijët, kompensohej me buzëqeshje të Kryeministrit. Një skandal i vërtetë. Çdo kryeministër që mund të jetë në krye të një



shteti, në raste të tilla, së paku, do të pushonte nga puna Ministrin e Arsimit dhe shumë të tjerë për angazhimin e fëmijëve në të tilla maskarada.

Kryeministri ynë i nderuar ndihet "rehat" nëpër sallat plot fëmijë të kampit socialist, sikundër Berisha në kampin demokrat. Në këtë fushatë, e cila dallohet për një etiketë më qytetare midis kandidatëve të rritur, po spekulohet tmerrsisht me fëmijët.

Mesa duket, pa e vulgarizuar problemin që po e trajtojmë, gati-gati po përgatiten "gladio" të dy kampeve politike me pasoja fatale, që do të bien mbi mësuesit, shkollën dhe kombin. Themi mbi mësuesit, sepse ata përditë ballafaqohen me "ndeshje" midis nxënësish dhe grupe nxënësish që mburrin ose shajnë kundërshtarët po-

litikë. Në shumë raste edhe mësuesit bëhen palë.

Ndërsa shkolla, që me ligj është depolitizuar, vihet në dispozicion të asaj force politike që është në pushtet. Në ditët e mësimëve, bëhen veprimtari politike. Auto-busët mbushen me nxënës shkollë të paraprirë nga flamujtë partiakë. Në këto raste, sa më shumë nxënës të

e kanë përfituar këtë përvojë?

Pretendojnë se po shkojnë drejt Evropës dhe nuk shikojnë dhe mësojnë nga ajo. Marrim SHBA-në si model dhe vepromë në kahe të kundërta të fushatave të saj. Ku drejtin i mësojnë këto përvoja?!

Të themi nga përvoja e vendeve komuniste, por edhe ata, fëmijët i dërgonin nëpër salla vetëm për t'u çuar lule. Të mendojmë, me keqardhje, se ka dukuri fashiste të cilat, i organizonin fëmijët që katërvjeçarë. Por dhe fashistët i organizonin fëmijët në një grup për t'i hedhur totalisht kundër kombeve të tjera, ndërsa në Shqipëri fëmijët ndahen kryesisht në dy grupe për t'i hedhur njëri kundër tjetrit. Organizimi partiak i fëmijëve shkon aq larg, sa na kujtojnë skenat e filmave gjatë Luftës së dytë Botërore. Grisje fotografish dhe posterash si dhe shkrim e prishje parullash të kundërshtarëve politikë.

Verbëria politike ose fitorja me çdo çmim, do ta sakrifikojë këtë brez, të cilin, në vend të dashurisë, po i kultivojmë urrejtjen që, pa dyshim, sjell viktima.

Shpërfillja ndaj të drejtave të fëmijëve është e tejskajshme. Nuk kihet parasysh se të drejtat e tyre mbrohen nga shumë konventa e të drejta ndërkombëtare, si ato të OKB-së të Këshillit të Evropës, Kopenhagenit, Helsinkit etj. Shteti, pavarësisht se i cilës forcë politike është, e ka për detyrë parësore të kujdeset për brezat e tij. Fëmijët nuk duhen përdorur si manikine.

Sami Starova
Kryetar i shoqatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

MEDIAKAFE...

Një qytetar u ndal në një nga rajonet e Bashkisë për të marrë një certifikatë. U afrua te sporteli i gjendjes civile, por punonjësja e drejtoi për te sporteli tjetër.

Aty po e priste një zonjë e rreptë:

-Duhet të paguash taksën e shtëpisë që të marrësh certifikatë!-i foli zonja me ton.

-Taksën e shtëpisë?! Po unë nuk kam shtëpi këtu në Shqipëri. Jetoj në Gjermani. Jm nga ata të ambasadave të '90-ës- i foli i habitur emigranti.

-Nuk dua të di se ku banon e kur ke ikur! Pa paguar taksën e shtëpisë, nuk merr certifikatë. Ky është urdhër,-u përgjigj zyrtarja.

-Nuk kam pasur shtëpi as në kohën e ... , jetonim me qira, më kuptoni? - Sqaroi i ardhuri nga larg.

Punonjësja e taksave u mendua paksa dhe iu drejtua:

-Nuk ke shtëpi? Pse Berati, Shqipëria nuk është shtëpia jote? - Kaq shpejt i harrove? Emigranti nxori shpejt e shpejt portofolin dhe pagoi taksën.

-Më fal, zonjë e nderuar!- i tha - Ke plotësisht të drejtë. Hiç nuk u thellova.

Mori faturën dhe u drejtua për te sporteli tjetër.

Lexuesi i thekur i gazetave u ul në kafene. Hapi gazetën dhe nisi të lexonte listat e këshilltarëve të dy partive. Nxori një copë letër dhe pasi vizatoi një fushë futbollit, filloi të vendoste këshilltarët përballë njëri-tjetrit në dy skuadra: portierët, qendërmbrojtësit, stoperin, mbrojtësit anësorë, half-ët dhe sulmuesit. Kur e plotësoi fushën, u mahnit nga përzgjedhja. Të dy ekipet, në çdo sektor të fushës i përgjigjeshin shkëlqyeshëm njëri-tjetrit. Me të njëjtin stil loje, mendimi, force deri edhe dobësie. E torturonte mendimi: Cili vallë nga trainerët e bëri i pari formacionin?! Tani apo Fadili? Sidoqoftë, - mendoj, - ndeshja do të jetë e bukur. Do të kemi spektakël.

Kujdes! Hap sytë, se mos rrëshqet!- i foli elektrikisti që nga toka kolegut të tij që punonte në majë të shtyllës.

-Edhe po rashë, nuk shkoj dëm, - foli nga maja e shtyllës tjetri, - do më shpallin hero dhe ti do të vish çdo përvjetor me lule dhe do të përulësh para bustit tim.

-Të lutem, hap sytë, se mos rrëshqet! Aty e kam hallin edhe unë. Kemi kaq shumë njerëz të nderuar: deputetë dhe kandidatë për deputetë, kryetarë dhe kandidatë për kryetarë, shefa, kapo, dëshmorë e heronj, saqë Shqipëria nuk i ngre dot. E shikon si është krrusur?

Kemi nevojë për elektrikistë, bukëpjekës, kopshtarë, bletërritës... pra kemi nevojë për popull. Ai na mungon.

Ndërkohë elektrikisti tjetër kishte zbritur në tokë dhe vështronte i habitur kolegun e tij.

Gent Panariti

Konsullata italiane sjell në Berat Verdin e Puçinin

Konsullata italiane me qendër në Vlorë dhe qendra kulturore AKSI në qytetin e Beratit kanë organizuar një koncert sinfonik pak ditë më parë. Aktiviteti me pjesë të zgjedhura të autorëve të muzikës sinfonike italiane është zhvilluar ditën e shtunë në mjediset e qendrës kulturore AKS, rreth orës 11.00. Për të ndjekur nga afër këtë koncert kanë marrë pjesë përfaqësues të konsullatës italiane me qendër në Vlorë, artdashës të muzikës e të ftuar të tjerë. Drejtuesi i qendrës kulturore AKSI Vladimir Çela, u shpreh para fillimit të koncertit për gazetën se ky nuk është bashkpunimi i parë

me konsullatën italiane dhe ky aktivitet patjetër që nuk do të jetë i fundit. Nën drejtimin e orkestrës sinfonike të qytetit të Beratit, të pranishmit ndoqën pjesë të autorëve italianë: Vivaldi me La Primavera, Verdi me pjesë nga Traviata, Nabuko, Puçini me Aria e Johansonit, etj. Nga ana e tyre përfaqësuesit e konsullatës italiane pas përfundimit të koncertit u shprehën të kënaqur. Ata premtuan se do të përkrahin e mbështesin aktivitetet me qendrën kulturore AKSI.

Eriola Azizolli

PJESEZ NGA MASKARADA ELEKTORALE NE BERAT

Në ditën e zgjedhjeve të 12 tetorit isha vëzhgues i Partisë Demokratike në qendrën e votimit nr. 3292 të qytetit të Beratit. Kjo qendër votimi ishte e vendosur në katin e tretë të shkollës "Shyqyri Lakra", në ambjentet e së cilës gjendeshin edhe 3 qendra të tjera votimi. Me atributet ligjore që Kodi Elektorale i jep vëzhguesit, kam ndjekur për gjatë gjithë ditës procesin e organizimit të komisionit të votimit, procesin e votimit të qytetarëve, procesin e numërimit të votave dhe nxjerrjes së rrezultatit.

Duhet të nënvizoj që në fillim se procesi i votimit ka kaluar pa probleme, komisionerët e të tre forcave

politike (PD, PS dhe PSD) kanë mbajtur qëndrim përgjithësisht korrekt në zbatimin e ligjit dhe në tërësi, procesi i votimit dhe numërimit të votave ka qënë po ashtu mjaft korrekt. Por, vendosa të shkruaj këto rreshta për të dëshmuar e vërtetuar se pavarësisht rregullaritetit të procesit të votimit, zgjedhjet në këtë qendër votimi nuk ishin gjë tjetër përveç se një farsë elektorale.

1. Zgjedhjet si jo të barabarta.

Më 12 tetor 2003, së bashku me 7 komisionerët e qendrës së votimit dhe një vëzhgues tjetër, unë u bëra dëshmitar i përjashtimit të madh të votuesve nga procesi i votimit. Unë pata durimin të numëroj të gjithë qytetarët që u paraqitën në qendrën e votimit nr. 3292 dhe

që nuk mundën të votonin, pasi emrat e tyre mungonin në listën e votimit. Ata ishin gjithsej 42 persona, por unë kam evidentuar nominalisht 37, pasi 5 të parët i konsiderova si problem rastësor. Fenomeni i diskriminimit publik të qytetarëve përbën një shkelje flagrante të të drejtës së tyre kushtetuese për të zgjedhur dhe është një argument më se i mjaftueshëm që **zgjedhjet në qv. Nr. 3292 të konsiderohen si jo të barabarta.**

2. Zgjedhjet si të pavlefshme.

Rrezultati i zgjedhjeve në qv. nr. 3292 është teorikisht dhe ligjërish i pavlefshëm. Për të argumentuar këtë po ju paraqes të dhënat që rrezultuan nga numërimi i fletëve të votimit

"Votues të rregjistruar në listë: persona	489
"Votuan sipas listës :	156
"Vota të vlefshme për kandidatët: vota	149
"Vota për kandidatin socialist:	73
"Vota për kandidatin demokrat:	50
"Vota të vlefshme për subjektet politike:	149
"Vota për Partinë Socialiste:	61
"Vota për Partinë Demokratike:	49

Nga pasqyra e mësipërme shihet se diferenca ishte respektivisht 23 vota për kandidatët dhe 12 vota për partitë. Në rast se do të kishin votuar 42 personat që u paraqitën në qendrën e votimit për të shprehur vullnetin e tyre, (por që nuk u lejuan të votonin, pasi s'figuronin në listën e zgjedhësve) rrezultati i votimit teorikisht do të ishte krejtësisht i ndryshëm. Ky rrezultat mund të ndryshonte në favor të kandidatit demokrat dhe PD-së, ashtu sikurse mund të ruante të njëjtën tendencë apo edhe të thellohej në favor të PS-së. Përderisa rrezultati pas kryerjes së shkeljes kushtetuese të përjashtimit të votuesve mbetet krejtësisht i hapur dhe i diskutueshëm,

përditë, por atë ditë ata ishin gati t'a shqyenin atë. Komisionerët socialistë, të struktur dhe të vrerosur, bile tmerrësisht të shqetësuar pse po shënoja emrat e personave që nuk votonin, mund t'a tregojnë më mirë se unë atë që përjetonin atë ditë. Unë po përmend vetëm disa batuta të "armiëve të klasës" të përjashtuar nga votimi: "Këta janë më të mençur se Enveri. Enveri i dënonte kundërshtarët nëpër gjyqe, dhe vetëm pasi i burgoste u hiqte atyre të drejtën e votës. Fatos Nano iu zhduk për së gjalli identitetin dhe pastaj iu "garanton të drejtën e votës". "Këta, (socialistët) i bëjnë të tëra, këta



nuk janë socialistë; këta janë specialistë." "Këta të heqin nga defteri për së gjalli!"

E çfarë s'mund të presësh nga këta? Çfarë lanë ata pa bërë?!" etj, etj.

Por qytetarët e indinjuar nuk linin mënjane as Sali Berishën në batutat e tyre të indinjatës. "Sot Berisha duhet të marrë një vendim të madh - thoshin ata. Ai, me fuqinë e mandatit të kryetarit të Partisë Demokratike duhet të nxjerrë Opozitën Shqiptare nga ky kurth i ndyrë. **Ai duhet t'u ngarkojë sot komisionerëve të opozitës misionin historik të shpëtimit të zgjedhjeve.** Ai duhet të ndërromarrë sot një akt të madh. Ai ka mundësinë e komunikimit me komisionerët brenda një kohe të shkurtër. Sali Berisha duhet të shpëtojë

është jo vetëm logjike por edhe ligjore që **zgjedhjet në qendrën e votimit nr. 3292 të konsiderohen të pavlefshme.**

Në fund të këtij shkrimi, paraqitet lista e 37 personave që u paraqitën në qv. nr. 3292 por që nuk u lejuan të votonin pasi s'figuronin në listën e votimit.

Me statusin e vëzhguesit të drejtëpërdrejtë të procesit të votimit, paraqita më sipër aspektet tekniko-ligjore që i bëjnë zgjedhjet në q.v. nr. 3292 të pavlefshme. Por vendosa të shprehem me këto rreshta për të përshkruar me pak fjalë indinjatën dhe zemërimin e qytetarëve që vinin të votonin dhe nuk mundnin të votonin. Ata që prej 1991-it kishin votuar tek ajo shkollë. Ata ishin që të gjithë banorë të lagjes "Kushtrim", që të gjithë të njohur të komisionerëve socialistë e demokratë të komisionit. Dhe, pasi kërkonin emrin e tyre në 3 qendrat e tjera të votimit në katin e parë dhe të dytë, vinin me shpresën se do t'a gjenin më në fund emrin tek qendra e fundit. Por as këtu nuk e gjenin. Pastaj ata shpërthenin. Ata shfrynin me indinjatë e zemërim të skajshëm kundër qeverrisë - klikë të vendit, që pasi i rropi së gjalli, ju vodhi edhe identitetin. Në fakt, ata qeverrinë e shajnë

zgjedhjet! Ai duhet t'a bëjë këtë sot dhe vetëm sot! Nesër është vonë." Dhe zgjidhja sipas tyre ishte "Tërheqja e komisionerëve dhe braktisja e zgjedhjeve!"

Ndërsa degjoja qytetarët e diskriminuar tek shfrehnin dufin e tyre, perpiqesha të gjykoja ftohtë mundësinë e ndërmarrjes se një vendimi të tillë nga ana e Kryetarit të PD-së. Më dukej një vendim jo i lehtë, jo demokratik, jo normal për PD-në, por vrisja mendjen dhe nuk gjeja asnjë zgjidhje tjetër. Njerëzit mezi kishin prituri ditën të shpreheshin kundër klikës. Të shpreheshin me të drejtën e tyre kushtetuese, për të ligjitimuar një qeverrisje tjetër. Por ata nuk u lejuan. Bile, për të disatën herë. Edhe pse kësaj radhe opozita i kishte garantuar se me listat nuk do të kishte probleme. Ndërkohë që kishte ndodhur batërdia. Ndaj edhe u jepja të drejtë kur s'arrinin të kontrollonin vehten.

* * *

Kanë kaluar ditë nga 12 tetori. Janë shpallur fitimtarët dhe humbësit. Por e humbura më e madhe është Shqipëria. Ajo ka humbur institucionin e zgjedhjeve.

Ali LYBESHARI

Anëtar i kryesisë së PD-së Berat


Mendime rreth një debati

Ka ca kohë që, kur kryqëzohemi Krrugës me z. K. Kuka, shkëmbejmë përshëndetje. Nuk mbaj mend të na ketë prezantuar ndokush. Është një njohje indirekte dhe një respekt reciprok.

Fillimisht e kam njohur si emër, gati dy vjet më parë, nga një shkrim në "Gazetën Tomori", 17-23 dhjetor 2001. E vlerësova shumë shkrimin e z.Kadri Kuka "Përse hesht Adyl Pilafi?".

Kuptohet, ky ishte njëkohësisht edhe një vlerësim për z.Kadri Kuka. Fill pas një viti, në "Gazetën Tomori", 9-15 dhjetor 2002, zoti Kuka bën një shkrim, në të cilin ul poshtë personalitetin e z.Balil Gjini. E përgojon, e fyen, e zhvlerëson si intelektual, e sulmon deri atje ku s'mban më.

Pas dy javësh po në "Gazetën Tomori", 23-29 dhjetor 2002, në shkrimin "Kuka: shpreh pendesë publike", drejtuar Myftimisë dhe Qendrës për Kulturë Islame në Berat, zoti Kuka, kërkon ndjesë duke e justifikuar fyerjen, që i bën institucionit dhe besimit islamik, si një "lapsus calami". Dhe po aty shkruan: "në edukatën,



kulturën dhe besimin tim s'e kam zakon të fyej asnjëri e jo më institucione.

Për të qenë i sinqertë, që atëherë më lindën disa pikëpyetje për çiltërsinë e pendesës së z. Kuka.

Z.Kuka i kërkon ndjesë Myftinisë dhe besimtarëve islamikë, por harron t'u kërkojë falje edhe atyre "disa pleqve të përhumur që vegjetojnë e gërhasin". Ishte fjala për pensionistë që lexojnë gazetën falas në sallën e bibliotekës.

Po në këtë shkrim "Pendesë...", ku është shprehur se "s'e ka zakon të fyejë asnjëri", harron sa rëndë e ka fyer z. Balil Gjini, të cilin e karakterizon si njeri me "javashllëk mendor"... "me fjalorin e tij shpirtzi, që tregon kulturën e tij të mangët dhe formimin e tij fshataresk"... etj.etj. Dhe kjo, si e theksuam, më pak se një vit më parë.

Tetor 2003, në gazetën "Lajmëtari i Beratit" botohet shkrimi i titulluar "Poezi tronditëse, poezi të shkëlqyera..." me autor z.Kadri Kuka. Në këtë shkrim z. Kuka shprehet me superlativa për vlerat intelektuale të z.Balil Gjini.

Meqenëse i kam lejuar vetes të citoj fjalët fyese për z.Balil, të botuara në "Gazetën Tomori", kërkoj

leje nga lexuesi të citoj fjalët po të z. Kuka për vlerat e poezisë së z.Balil Gjini, botuar këtë herë në gazetën "Lajmëtari i Beratit":

"Balil Gjini është një poet i magjishëm, me një perandori figurash dhe tropesh figurative të jashtëzakonshme, tronditëse, të shkëlqyera. Poezia e Balil Gjinit është një poezi me një arkitekturë mahnitëse, me një ndërtim figurativ të paarritshëm"... "Është një poezi... me një shkëlqim... aristokratik..." etj.etj.

Besoj se kaq mjafton për të

nxjerrë dy përfundime:

Së pari, Zoti Kuka ka treguar kurajë civile dhe kulturë qytetare duke i kërkuar ndjesë zotit Balil për fyerjet që i ka bërë një vit më parë në "Gazetën Tomori". Sipas mendimit tim këtë e tregon më shumë se një tofjalësh i ngrirë, shkalla e lartë e vlerësimit që i bën zoti Kuka zotit Balil Gjini në analizën poezisë të tij.

Zoti Kuka merr guximin të pohojë se "Arti s'është as i majtë as i djathtë". Dhe nëse mendimi nuk është plotësisht i saktë, është goxha i goditur.

Së dyti, personalisht duke u njohur me përkthimin e përkryer të z.Balil Gjini "Histori botërore dhe qytetërimi", gjeta në shkrimin e z.Kuka, afirmimin e mendimit tim për vlerat intelektuale të z.Balil.

Në mbyllje të këtij shkrimi, dëshiroj që me dashamirësi t'u bëj një apel intelektualëve: Larg nga fyerjet, që zbehin figurën e secilit. Respektoni mendimin e secilit.

Replika me z.Elio Kondi do të ishte e panevojshme, se heshtja nuk është gjithnjë miratim i asaj që shkruhet, se "heshtja është flori". "Toleranca, si praninë e tjetrit, -siç shkruan z. Y. Hima, është virtyt i një shoqërie demokratike".

Fatmir Berati

Në pritje të kreut të ri të bashkisë

Kanë kaluar plot katër javë nga përfundimi i zgjedhjeve vendore dhe ende nuk është bërë konstituimi i kryetarit të ri të kësaj bashkie. Ndonëse rezultatet e këtyre zgjedhjeve u bënë publike zyrtarisht nga K.Z.Q.V-ja, vetëm një javë pas përfundimit të procesit, pas shpalljes së tyre paraprakisht nga partitë politike, ende kryetari i ri i Bashkisë e nuk është ulur në karrigen e tij. Ende nuk është caktuar data e konstituimit që do të sjellë në krye të Bashkisë kreun e socialistëve beratas, Fadil Nasufin. Askush nuk jep shpjegime pranë kësaj bashkie se përse nuk po zhvillohet konstituimi, përderisa nuk kemi të bëjmë me një proces ligjor të kontestueshëm të zgjedhjeve, përpos disa denoncimeve të bëra nga opozita. Ndërsa Nasufi po pret konstituimin për të marrë drejtimin e bashkisë, Mata po kalon ditët e fundit në këtë post. Gjatë orëve të punës shumë prej zyrrave të Bashkisë janë të mbyllura, ndërsa nuk



mungojnë dhe ekskursionet e zyrtarëve me në krye kryetarin Mata. Qytetarë të ndryshëm në një prononcim për gazetën "Lajmëtari" shprehen se qëndrojnë me orë të tëra përpara Bashkisë për problemet e tyre, pasi askush nga administrata nuk përgjigjet dhe qytetarët janë në pritje të kryetarit të ri.

Plagos me thikë dhëndërin, ndalohet nga policia

Një grindje për motive ende të pazbardhura ka bërë që një 35-vjeçar të përfundojë në spital i plagosur me armë të ftohtë, ndërsa autori të ndalohet nga policia. Burime të komisariatit të këtij qyteti, bëjnë të ditur se paraditen e ditës së shtunë është plagosur me thikë 35-vjeçari Nikollaq Kule, lindur e banues në fshatin Sinjë të këtij rrethi. Policia është njoftuar për ngjarjen nga spitali i këtij qyteti ku ishte dërguar i plagosuri për të marrë ndihmën e parë. Burime të qendrës spitalore bëjnë të ditur se Kule ishte paraqitur me një plagë në brinjë, shkaktuar nga një armë e ftohtë, thikë. Pas marrjes së ndihmës së parë shëndetësore ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Pas marrjes së deklarimeve rreth orës 15.00, policia prangosi autorin e plagosjes 68-vjeçar Petraq Dundo, lindur e banues në fshatin Pashalli të këtij rrethi. Nga deklaratimet e para policia mësoi se ngjarja ka ndodhur mesditën e ditës së shtunë në fshatin Pashalli, dhe punon për të mësuar motivet e grindjes që çoi në plagosjen e 35-vjeçarit.

Mjekët japin alarmin të ndalohet tregëtimi i barnave helmuese pa rekomandim

Vethelmohet 68-vjeçarja

Një grua 68-vjeçare i ka dhënë fund jetës mesditën e ditës së enjte në qytetin e Beratit duke shënuar kështu rastin e 29 të vetvrasjeve në këtë qytet brenda këtij viti. 68-vjeçarja Heteme Cima, lindur e banuese në lagjen "30 vjetori" të këtij qyteti ka gjetur vdekjen rreth orës 15.00 të ditës së enjte pas konsumimit të një sasive të konsiderueshme fotoksine. Gruaja ka mbërritur rreth orës 14.30 në repartin e urgjencës së qendrës spitalore në gjendje të rëndë shëndetësore. Pas vizitës së kryer, mjekët kanë konstatuar se gruaja kish pirë preparat helmues dhe i kanë ofruar menjëherë ndihmën e parë shëndetësore. Por, sasia e konsiderueshme e helmit kish vepruar në organizmin e saj dhe me gjithë ndihmën e dhënë, rreth orës 15.00 gruaja ka ndërruar

jetë. Nga deklaratimet e familjarëve mësohet se 68-vjeçarja e ka blerë preparatin helmues vetë pasi ata nuk dispononin diçka të tillë në banesën e tyre. Familjarët dyshojnë se gruaja gjatë kohës që bënte pazarin e shtëpisë, ka blerë dhe helmin me të cilin i dha fund jetës, pasi fill pas tregëtimit ish gjetur në gjendje të rëndë shëndetësore. Grupi hetimor i policisë ka kryer hetimet e para për të zbuluar motivet e vetvrasjes. Nga vetë deklaratimet e familjarëve mësohet se kohët e fundit 68-vjeçarja vuante nga ndjenja e mërzisë që dyshohet se i ka shkaktuar një depresion të thellë. Pas këtij rasti të 29 të vetvrasjeve në këtë rreth, mjekët e qendrës spitalore të këtij qyteti japin alarmin se vetvrasja po shndërrohet në dukuri tepër shqetësuese prandaj duhet urgjentisht të ndalohet tregëtimi i preparateve helmuese pa rekomandim.

Shkolla 8-vjeçare e fshatit Dyshnik në gjendje të mjeruar

Shkolla tetëvjeçare e fshatit Dyshnik në rrethin e Beratit ndodhet në gjendje krejtësisht skandaloze. Janë rreth 100 nxënës që mësojnë në këtë shkollë, e cila vetëm e tillë nuk mund të quhet. E ndërtaur vite më parë, kjo shkollë nuk ka pësuar as ndërhyrjen më të vogël, çka ka bërë që aktualisht të ndodhet krejtësisht e rënuar. Tavani i shkollës ka nisur të pikojë ndërsa muret kanë rënë. Si nxënësit dhe mësuesit e shkollës shprehen se është e pamundur të zhvillohet mësim në këto mjedise tashmë që ka ardhur stina e dimrit. Mungesa e xhamave dhe e dyerve bën që nxënësit ta kenë të vështirë qëndrimin në klasa, sidomos gjatë ditëve me shi. Burime nga drejtorja e shkollës bëjnë të ditur se disa herë janë bërë kërkesa për investime, por deri më sot agjë nuk është bërë. Ndërsa pohime

nga Drejtorja Arsimore shprehen se mungesa e lëvrimin të fondeve nga Ministria e Arsimit ka bërë që kjo shkollë të ngelet në këtë gjendje. Nga ana e tyre prindërit shprehen të shqetësuar se, me afrimin e ditëve më të ftohta, fëmijët do të jenë të kërcënuar jo vetëm nga i ftohti, por edhe nga shiu që futet në klasa si pasojë e mungesës së sigurimit të dritareve. Po sipas burimeve nga Drejtorja Arsimore bëhet e ditur se do të merren masa për vënien e xhamave të dritareve për të krijuar sadopak kushte për mësuesit dhe nxënësit. Dhe si të mos mjaftonin të gjitha këto, probleme ka dhe me bazën materiale, ku klasave u mungojnë bankat, karriget, ndërsa ato aktualet kanë dalë krejtësisht jashtë përdorimit. Të detyruar në këto kushte, nxënësit dhe mësuesit zhvillojnë çdo ditë mësim me shpresën e vetme që të mos bjerë shi.

Përgatiti: Eriola Azizolli

Të bjerë apo të mos bjerë shi?

Një shaka me pak kripë

Ka një pyetje që na mundon: "Të bjerë apo të mos bjerë shi? Se të bjerë shi është edhe mirë edhe keq. Po kështu, edhe po të mos bjerë shi, është edhe mirë edhe keq."



Le ta shohim pak më shtruar, me më pak durim këtë çështje.

Kur bie shi na pastrohet mjedisi nga plehurat, na pastrohet ajri nga ndotjet, na ushqehen bimët e të mbjellat me ujin e nevojshëm për rritjen e tyre, na shtohen burimet, na rritet niveli i ujërave në rezervuarët e hidrocentraleve dhe do të kemi më shumë energji elektrike...

Po krahas këtyre të mirave kemi edhe ca të këqia. Kemi edhe ca dëme. Po përmend disa prej tyre. Na zbresin me uturimë përrrenjtë nga kodrat dhe na mbushin rrugën, ka raste edhe dyqanet me gurët dhe llumin që sjellin, se nuk është menduar për t'i drejtuar këto ujëra në rrugën e duhur. Dhe na duhen, në këto raste, edhe çizme peshkatarësh për të hyrë nëpër shtëpitë tona. Na turbullohet uji i pijshëm që na vjen nga Bogova, dhe për

ditë të tëra nuk kemi çfarë të pimë, as me se të lahem.

Po kur nuk bie shi? Atëherë fillon një e keqe tjetër. Na mbytet thatësira. Lumi kthehet në një përrua. S'ka ujë as për vete, jo të ketë për vaditje. Pakësohet uji i pijshëm. Ulet niveli në rezervuarët e hidrocentraleve. Pra, thellohet më shumë ndërprerja e dritave. Rritet ndotja e qytetit. Fillon kriza e përgjithshme.

Ç'duhet të bëjmë në këtë rast. E ç'mund të bëjmë?!

Ne e dimë se rënia apo mos rënia e shiut nuk është në dorën tonë.

Ne e duam shiun. Se ai është burim jete. Po s'i i bëhet halli me përmbytjen e qytetit dhe me ujin e pijshëm që na ndotet?

Një plak i urtë dha këtë mendim që po jua parashtraj:

Për të shpëtuar nga përmbytjet e vazhdueshme, të ndërtohet një tendë e

madhe që ta mbulojë të gjithë qytetin dhe rreth saj të vendosen ulluqe që ta mbledhin ujin dhe ta derdhin në Osum. Vetëm kështu kodrat rreth tij nuk do të gërryhen dhe dherat nuk do të marrin rrugët. Sa për nevojën e bimëve për ujë, të përdoren pompat, uji t'i merret lumit, t'i kërkohet borxhi që i kemi dhënë në kohën e shirave. Edhe për të ruajtur ujin e Bogovës nga ndotja të vepronhet me të njëjtën mënyrë. Të mbulohet mali i Tomorit me një tendë të madhe, që ujërat e shirave të mos na e turbullojnë ujin. Rrugë tjetër s'ka.

Thonë se së shpejti Bashkia do të shpallë tenderin për të vënë në jetë këtë mësim të këtij plaku të urtë.

Le të shpresojmë se ditët e mira paskëtaj do të vijnë.

Agron Feriti

Banorët e fshatrave me ujë dhe pa ujë të pijshëm

Komunat e Kutallisë dhe Poshnjes me 14 mijë dhe 9 mijë banorë kanë vite që vuajnë për ujin e pijshëm

Për zonën e Kutallisë me 13 fshatra, qysh në kohën e monizmit aty nga viti 1988, është ndërtuar rrjeti i ujit të pijshëm nga ujësjellësi rajonal i Banajt i cili nuk e pati jetën të gjatë si rrjedhojë e trazirave të vitit 1990, për të cilin shteti investoi 250 milionë lekë. Kurse për rikonstrukcionin e tij në vitin 1994 janë investuar 265 milionë lekë dhe ujë në rubinetat e banorëve të këtyre fshatrave nuk erdhi, ndonëse rrjeti pak a shumë është i shtruar të paktën për tre fshatra, Goriçan Qendër, Goriçan Çlirim dhe Malas Breg. Në Drenovicë dhe Samaticë e blejnë ujin nga botet që vijnë nga Bogova. Mirë për të pirë, po për të larë e gatuar? "Më vjen keq të largohem nga fshati, se kam tokë dhe shtëpi, - shprehet njëri prej këtyre banorëve të zonës së fushës. Më keq paraqitet gjendja në fshatin Goriçan, i cili dhe në kohën e monizmit ka patur të njëjtën situatë, sepse, sipas specialistëve, kjo zonë është pa rezerva ujore. Edhe sot e kësaj dite këtu qarkullojnë vargjet e këngës së viteve 1964, kur buka ishte me 400 gr për frymë dhe ujë nuk kishte fare: "Goriçani teleferiç / bukë pak e ujë hiç". Ku nuk kanë shkuar banorët e këtij fshati, në prefekturë, qark, te deputeti i zonës, deri dhe me letër te Kryeministri, dhe ka pak gjasa se mund të zgjidhet gjë.

Po të shikojmë se si paraqitet gjendja e burimeve ujore në zonën e Poshnjes, do të bindeni, se legjendën e ujit e krijojnë shtetarët me indiferentizmin e tyre dhe moskokëçarjen për ato që kanë premtuar para popullit.

Në zonën e Mesit të Urave, siç quhet Poshnja, ndodhen këto burime ujore: Në fshatin Gajdë ndodhet stacioni i pompimit i ngritur në vitin 1977, që furnizon me ujë fshatrat e rethit të Lushnjes, ndërsa vetë fshati Gajdë dhe fshatrat Agim, Kuç, Hingë që ndodhen pak metra larg këtij vendburimi, nuk marrin ujë të pijshëm. Kësaj i thonë të shkosh në lumë dhe të mos pish ujë. Në fshatin Arrëz

të Poshnjes merr ujë Kuçova. Në fshatin Çiflig merr ujë Ura -Vajgurore këto fshatra nuk kanë ujë për të pirë. Në fshatin Poshnje merr pjesërisht ujë Berati. Dhe vetë Poshnja nuk pi ujë. Në fshatin Banaj ndodhet stacioni i ujit të pijshëm për komunën e Kutallisë ndërtuar që në kohën e Ramiz Alisë, kurse fshatrat Banaj, Syzez, Malas Gropë, që ndodhen fare pranë ujësjellësit, nuk kanë ujë për të pirë. Pra, të gjitha këto vendburime ndodhen brenda territorit të komunës së Poshnjes, e cila nuk dihet në u merr tatim këtyre objekteve apo jo. Duke u ndodhur në këto situata, banorët e këtyre fshatrave me të drejtë shprehin: "Ujë japim e ujë nuk pimë".

Tashmë banorët e kuptuan lojën e pushtetarëve, se premtimet janë bërë pjesë e refrenit në raste fushatash. Banorët e zonave rurale, që tashmë i janë kthyer punës duke braktisur kurbetin, kërkojnë vetëm ujë për të pirë. Ne do t'u jepnim të drejtë atyre kur të mos kishte burime ujore, por kur ato janë dhe nuk vihen në shfrytëzim, me plot gojën mund të themi, që shtetarët dhe gjithë të zgjedhurit krijojnë situata të panevojshme. Ç'mund të themi për banorët e fshatrave Malas Breg, Goriçan-Qendër dhe Goriçan -Çlirim të komunës së Kutallisë, që dhe tubacionin e kanë patur të shtruar këtu e 14 vjet dhe që tani është amortizuar, sepse nuk u furnizua me ujë, për një problem qesharak, sepse ujësjellësi i përkiste një komune tjetër dhe nuk u gjend për gjithë këto vite forma për të paguar punonjësit e stacionit. Sot ky rrjet ka dalë jashtë loje dhe kërkon rikonstrukcion nga e para.


Tani banorët kanë hequr çdo lloj shprese, me gjithë premtimet që janë bërë pa kursim. Kur uji të rrjedh në rubinetat e çezmave do të besojnë banorët. Deri më sot legjendën e ujit e kanë krijuar vetë shtetarët.

Nezir Vrapi

Përse duhet të dënohemi kolektivisht?!

Që në fillim duam të themi se dënimi kolektiv është i paligjshëm. Nuk ka si të jetë i rregullt dënimi kolektiv me mungesën e energjisë elektrike. Është plotësisht e drejtë dhe e arsyeshme që ata që nuk e paguajnë energjinë, të mos furnizohen. Energjia është mall si gjithë të tjerët. E harxhove, paguaje; nuk ke të paguash, mos e përdor. A ka faj shteti që qytetarët nuk paguajnë energjinë që konsumojnë? Pikërisht fajtori kryesor dhe i drejtëpërdrejtë është ai, dhe vetëm ai. Ja pse. Kur qeveria demokratike rriti çmimin e bukës dhe atë të energjisë, të dy këto artikuj bazë i kompensoi, (siç kompensoi një shportë të tërë artikujsh të tjerë). Ndërsa ata që u digjet zemra për shtresat e varfëra, sepse janë parti sociale (iste), as që duan t'ia dinë për shumicën e elektoratit të tyre që u jep votën. Janë pikërisht qytetarët me ngjyrë që janë më të varfërit, janë këta që votojnë për Fatos Nanon me kompani, por janë po këta që nuk ia dinë derën dhe sportelin e arkës së elektrikut për të shlyer detyrimet që i kanë. Ky palo shtet, jo vetëm që nuk kompensoi familjet me lekë për të paguar energjinë, por nuk u jep fonde të mjaftueshme as institucioneve për të paguar energjinë e harxhuar. Janë pikërisht institucionet shtetërore që harxhojnë si në dimër dhe në verë mijëra e mijëra KW energji, sepse janë këta drejtorë e kryetarë që kanë në përdorim kondicionerë nëpër

zyra. Është fajtor ky palo shtet, sepse nuk ka punë, punë e cila do të siguronte lekët e duhur për të paguar energjinë. Ka faj, sepse u jep një palo asistencë të papunëve që as për të vrarë veten me bar miu nuk del, e jo më të paguash lekët që kërkon KESH-i; që e ka çuar çmimin e dritave sikur të paguheshin si punëtorët gjermanë, italianë, francezë. Rrogat e buxhetorëve pensionet asistencat e të papunëve, nuk i paguajnë dot paratë e dritave. Vetëm ministrat dhe deputetët nuk e kanë problem që t'i paguajnë ato dhe punonjësit e doganës as që duan t'ia dinë për këto vogëlsira. Me të mirë e me të keq, populli irslis (i ndershëm), bën ç'bën dhe i heq nga goja e fëmijëve paratë e dritave dhe ia paguan shtetit, sepse do të jetë në rregull me të. Po shteti sojsëz, i dënon këta irslis për të mbushur arkën e tij të zbrazur, që nuk mbushet as nga shteti e as nga militantët e shtetit, madje as nga vetë punonjësit e KESH-it dhe të policisë elektrike. Ka një "ligj" për Maliqtë që punojnë në KESH dhe në policinë e KESH-it, ata paguajnë jo aq sa harxhojnë; por një sasi shumë të vogël, paçka se tërë ditën e tërë natën gatuajnë e ngrohen me energji elektrike. Ja, për këta paguajnë ne orët e errësirës. Çfaj kanë ata qytetarë që janë të rregullt në marrëdhënie me KESH-in të rrinë në errësirë? Mos do vallë KESH-i që të rrëmbejmë ne hurin e të rrihem me fqinj që nuk paguan? Jo or mik jo, hurin me



emrin ligj e ke ti në dorë, ti përdore dhe për të bardhët dhe për të zezët, dhe për privatën dhe për shtetin, dhe mos na dëno të tërëve njëlloj. E di ti, miku ynë KESH, se sa lavazho punojnë me korent ku lanë makinat dhe ti veten, por që paguajnë sikur të kishin një furnellë. A e di ti, miku ynë KESH, se sa pompa punojnë nëpër shtëpi dhe paguajnë nën dorë si policët e elektrikut, si punonjësit e KESH-it? Zotërinj të KESH-it dhe të qeverisë, mësoni se në kapitalizëm gjithkush paguan për vete. Iku koha e Enverit kur punonte "qorri" dhe hante sakati. E dini ju zotërinj të KESH-it se dhe avokati i popullit e dënoi metodën tënde të punës atë të dënimit kolektiv? Që të jemi në rregull, ti duhet të vësh matësit në çdo shtëpi dhe secili të paguajë sipas harxhimit. E, pra, si qytet paguajmë 85-90 % të energjisë. Shumica e qytetarëve paguajnë prej vitesh 100% të saj. Atëherë përse na dënoni të rrimë në errësirë. Çfarë doni? Doni të dalim në rrugë, t'u thyejmë xhamat, t'u djegim zyrat? Jo, jo, ne nuk jemi ata të 97-ës, të tjerë janë ata që i bënë këto punë, pikërisht ata sot të dënojnë, sepse ti paguan me rregull energjinë. Ndëroni taktikë, zotërinj, para se të keni ndërruar zyrat. Se, helbete, me tapi nuk e keni marrë, sidomos kur nuk i bën yzmet punës.

Bujar Orizaj

Emocione nga Berati

Nga Yzedin Hima

Ngjarja artistike

Gjatë tri ditëve të fundjavës që kaloi në Berat u zhvillua Workshopi me piktorët Arben Golemi, Agron Polovina, Andi Na-

llbani, Gazmend Muka, Hasan Nallbani, Kastriot Dervishi, Leon Çika, Nexhmedin Musai. Gjithë artistët do të

realizonin punime në pikturë të frymëzuar nga peizazhi i Beratit. Ata punuan bashkë gjatë tri ditëve në lagjet Kala, Mangalem dhe

Goricë. Ky grup artistësh të talentuar, të njohur nga publiku për prurjet artistike dhe ekspozitat e shumta vetjake dhe kolektive të hapura brenda dhe jashtë Shqipërisë, realizoi 30 vepra, të

cilat u ekspozuan në Galerinë e Artit "Edward Lear" ditën e diel. Ekspozita me këto punime që një ngjarje artistike për qytetin e Beratit. Ndryshe nga ekspozitat e tjera, ajo

solli emocione dhe impresione të drejt-përdrejta. Asnjë nga veprat nuk doli nga muret e ftohta të atelierëve, por nga ngrohtësia që përcolli natyra.

Intervista me piktorin Kastriot Dervishi



Kastriot Dervishi

Dy fjalë për Workshopin

Mendoj se Workshopi më shkëputi nga rrjedha ime e zakonshme artistike. U ndërpre për pak ditë lidhjet e mia të natyrshme me artin dhe jetova një përvojë jo të zakonshme: punën në telajo drejtpërdrejtë me natyrën. I parë në spektrin organizativ, këtë workshop e bëri të mundur Fondacioni i Artit Kontemporan Vizual në Tiranë. Ky Fondacion bëri edhe përzgjedhjen e artistëve.

Përzgjedhja e artistëve u bë në bazë të kriterëve të drejtimit artistik, apo ...?

E përbashkëta është qëndrimi artistik i të gjithë autorëve, të cilët, po t'u vëresh veçan veprat e tyre, në përgjithësi, janë krejt të ndryshme në konceptet artistike. Ajo që i bashkon këtë radhë qenë emocionet dhe impresionet nga qyteti i Beratit, si parakusht miqësor midis artistëve dhe qëllimit të veprimtarisë. Kjo veprimtari synonte të zgjonte mjedisin artistik të qytetit të Beratit. Në një nga ditët e workshopit iu bashkua edhe fotografi i spektaklit dhe i modës, italiani Slim. Për Beratin ai u shpreh:


"Ajo çka po shoh sot në këtë qytet, nuk është ajo që ndodh në Shqipëri, më duket sikur nuk kam qenë ndonjëherë në këtë vend. Ky qytet është me profil njerëzor dhe mjaft i pastër".

Diçka për ekspozitën e mbrëmjes së të dielës:

Ndryshe nga ekspozitat e tjera, ajo u promovua pa ftesa. Artistët në një farë mënyre e organizuan ditën e ekspozitës për vete, që të shikonin se çfarë ndodhi gjatë tri ditëve me ta dhe me telajot e tyre. Për publikun ekspozita do të qëndrojë e hapur për dy javë. Pa dyshim rolin kryesor në realizimin e këtij projekti e ka piktori Arben Golemi, ideator dhe realizues i tij.

Vlerësime nga piktorët pjesëmarrës në Workshop

Hasan Nallbani



Hasan Nallbani

Të pikturuarit nuk është si sporti që mban trupin dhe shëndetin e mirë. Është diçka më tepër se një ushqim, të cilin mund ta provosh, ta refuzosh. Përkundër gjithë dashurive shtyese, arti është magjia më e thellë, më e qëndrueshme dhe më e domosdoshme për të zbuluar qenien dhe dëshirat tona. Berati është një strehë e ngrohtë për këdo që kërkon të realizojë gjithçka nga endrra të tilla.

Leon Çika

E bukura e kësaj veprimtarie ishte se u mblohdën së bashku ish-pedagogë dhe studentë, të gjithë piktorë të dashuruar pas penelit dhe Beratit. Por ajo që përbënte

emocionalen, ishte se këta i rikthehen natyrës së bashku mbas shumë kohësh që punojnë në studiot e tyre. Përvojë poetike dhe mocion shoqëror. Ishin tri ditë të mrekullueshme që ringjallën vërtetësisht dashurinë.


Andi Nallbani

Ndihem fatkeq që nuk jetoj në këtë qytet dhe me shumë fat njëkohësisht, se mrekullia e tij nuk do të bëhet asnjëherë e zakonshme për mua.

Arben Golemi

E thënë në tryezën e humorit, duke shfrytëzuar Shekspirin: "Berati është ngracka, ku piktorët kapen si laraskat".

Agron Polovina



Agron Polovina

Është një konfirmim i joshjes së përhershme të artistëve karshi Beratit, i cili mbetet qytet i papërsëritshëm. Është një përvojë e bukur krijimi në kompani, në një mjedis miqsh, me debate krijuese tavoline, ku humori është stolia më e bukur.

Nexhmedin Musai

Nderimin që Berati u bëri vizitorëve me bukurinë, lashtësinë e papërsëritshme të tij, vetëm piktorët ia kthejnë përjetësisht



Nexhmedin Musai



Kastriot Dervishi, Mangalemi

Ismail Qemali, burri që ngriti flamurin kombëtar

Me rastin e ditës së Shpalljes së Pavarësisë

Përvoja e gjatë si gazetar radioteleviziv më ka dhënë mundësi të marrë takime e të njihem me figura të shquara, ndihmesa e të cilave ka vlera atdhetare të pamohueshme. Takimet me Nermin Vlorën, me burrin e saj, diplomatin Renzo Falaschi dhe veprën e tij, më kanë ndihmuar të përcjell të lexuesit një pjesë të jetës, mendimit dhe veprimtarisë së shquar të Ismail Qemalit, duke shfrytëzuar dokumentat arkivale italiane të kohës.

letren e vet, porositi Ismail Qemalin të qëndrojë larg aventurierëve.

Ismail Mahmut Qemali, i lindur më 24 janar 1844 në Vlorë, largohet në moshën

Zosimea të Janinës vazhdon studimet për jurisprudencë në Stamboll , ku edhe punon si përkthyes në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Kultura e gjerë, zgjuarsia, mprehtësia



“Ju kam thënë dhe më parë se ju do të bëheni njeri i madh e vazhdoj ta mendoj këtë intuitë dyfishë profetike”, që mban datën 24 janar të vitit 1877, ku Charls George Gordon, në

pesëvjeçare nga vendlindja e bashkë me familjen qëndron në Selanik. Që në shkollën fillore mësoi turqishten dhe greqishten e re, ndërkohë që krahas gjuhës amtare fliste italishten dhe frëngjishten. Pas mbarimit të gjimnazit

dhe shpirti inisiator me interesa në fusha të ndryshme ishin faktorë që e pranuan në administratën osmane , ku arriti të ngjisë me shpejtësi shkallët e karrierës. Bashkëpunimi me Midhat Pashën e famshëm, si burrë

shteti liberal, ishte tepër frutdhënës. Idetë përparimtare, bazuar në zgjuarësi të rrallë natyrore, kuptohet që ngjallën nakar e dyshime, armiqësira që nuk vonuan të shfaqen jo vetëm në administratën shtetërore, por edhe deri te vet sulltan Abdyl Hamiti, që ia njohu e çmoi vlerat, por edhe i druhej këtij shqiptari.

Emërimi qeveritar në Varna të Bullgarisë dhe Kostancë të Rumanisë, u pasua nga shumë vite syrgjyn në Azinë e Vogël, për shkak të ideve liberale dhe programeve përparimtare që binin në kundërshtim të hapur me sulltanin. Kryevepra të vërteta realiteti dhe largpamjet politike, mbeten raportet mbi situatën e perandorisë, të drejtat e armenëve, për çështjen e Kretës, përhapjen ruse në Mesdhe, që ndikuan në ngritjen e figurës së tij në administratën e lartë perandorake. Besnik ndaj idealeve të tij, Ismail Beu, deputet në parlamentin e Stambollit, nuk pranoi portofolin e Ministrisë së Jashtme që iu ofrua. Qenien në krye të Partisë Liberale të Perandorisë Osmane, një manifestim i rrezikshëm, vetë e shpjegon:” ... në vendet autokratike të Lindjes, ku

mjafton vetëm mendimi i nderave liberale për të provokuar ngatërresa dhe për të menduar në çdo formë rreziku, liberalizmi rrethohet nga të këqija dhe rreziqe të mëdhaja: kurrë nuk e ndihmon njeriun të arrijë pushtetin, por, përkundrazi ata që e përvetësojnë këtë ide, e rrezikojnë pozitën dhe deri jetën e tyre...”

Publicisti William Fullerton në “kujtimit” shpreh konsiderata të larta për burrin e shtetit: “...Ismail Qemali ishte i trazuar nga problemet e mëdhaja vetiake, shpesh fort të mundueshme, nga preokupimet patriotike, nga intrigat për të ardhmen e Shqipërisë...”, por “gjykimi i tij ishte i denjë për besim...”. Harmonizimi i dëshirave vetjake me vizionin e vet konkret të ndjenjës me mendimin që bënë që me mjeshtëri të rrallë të lundrojë për një kohë midis vështirësive që shkonin deri në kanosje të jetës e përhapeshin si mjegull në botën e vjetër kozmopolite. Ky burrë shteti në jetën e vet kishte parë aq shumë gjëra e ndodhi, kishte njohur aq shumë personalitete, kishte jetuar me aq intensitet, sa që kishte si dhunti natyrore zakonet e vështrimit në thellësi e gjerësi e të kishte

interes kryesor intelektual vëzhgimin e mënyrës në të cilën faktorët njerëzor drejtohen e kombinohen për të vendosur raporte forcash që shumë rrallë pasqyrojnë qëllime të ndërgegjshme.

Në përshkrimin që i bën portretit të Ismail Beut, Sefa Vlora në “kujtimit e tij familjare” nënvizon: “... Ata që e njihnin dhe flisnin me të, mbeteshin të gjithë pa përjashtim nën përshtypjen se ishte burrë i mirë, i lartë nga shpirti dhe i urtë. Zotëronte zgjim dhe kulturë të thellë. Ushqente dashuri të madhe për Atdheun dhe lirinë. Ishte kryelartë për vendin e tij. Nuk kishte asnjë interes për pasuri, sepse nuk i jepte asnjë rëndësi pares në kuletë. Nuk prishte gojë me asnjëri si për kundërshtarët e tij, me folje të kadalshme dhe të ëmbël”.

Për të mos u bërë përsëri viktimë e syrgjynit të sulltanit në prillin e vitit 1990 e braktisi Turqinë, e në maj të po këtij viti, lë Stambollin e me një anije angleze që shkonte për në Athinë, kthehet për t'i kushtuar tërë energjitë e tij mendore e fizike vetëm çështjes shqiptare

Vijon në numrin e ardhshëm

Namik Gjoni



Shpejtësi - Siguri - Pastërti

Pastrim kimik me pronar Astrit Qafën



Nivel i lartë cilësor i pastrimit kimik të rrobave tuaja

Adresa: 20 m në krah të Postës në lagjen “Çlirim”

Tel: 069 20 85 220, 068 23 17 300

P
R
E
K
N
I
P
A
S
T
Ë
R
T
I
N
Ë

P
A
S
T
R
I
M
K
I
M
I
K

Në pritje të mëngjesit të ditës së mërkurë

Përsiatje në njëvjetorin e grupit popullor "Berati"



Agim Mehqemeja

Ishte 12 nëntor i vitit 2002. Plot një vit më parë, një grup dashamirës të këngës, kryesisht banorë të lagjes Goricë, vendosën të ripërtërijnë traditën e qytetit të tyre, të ringrejnë grupin popullor "Berati".

Kjo nismë është për t'u përgëzuar.

Me këtë rast s'ka si të mos na vijë ndër mend tradita e hershme e grupeve të tilla artistike, që kanë lulëzuar në vite e shekuj në Berat, duke u bërë në të njëjtën kohë edhe burim i pashtershëm i atyre këngëve të bukura beratase që i kemi të trashëguara dhe që na takon jo vetëm t'i ruajmë, por edhe t'u japim jetë, t'i ngrejme në skenë.

Siç na kumton Evlija Çelebiu, në përshkrimin e udhëtimit të tij të vitit 1670, Berati ka patur shtatëdhjetë vende dëfrimi, ku ngrihej ahengu. Ndër më kryesorët ai përmend qoshqet në Kalanë e Sipërme, në shkëmbin "Çekbeni", në

Kalanë e Poshtme, në Sofatet e Tabakhanës, në sheshin e Tregut të Ri, në Malin e Thatë (kështu quhej mali i Goricës)...

Grupet e këngëtarëve beratas, siç na e sjellin dokumentet e njohura deri më sot, kishin krijuar deri në shekujt XVI-XVII tajfatë (shoqëritë e tyre). Këto grupe ishin të vogla, me 5-10 instrumentistë virtuozë. Ato drejtoheshin nga një kryemuzikant (mehter-bash).

Edhe në vitet e mëvonshme kjo traditë nuk u shua. Çdo lagje, herë-herë edhe çdo rrugicë kishte grupin e saj të këngës. Në ditë gëzimesh, në festa popullore, mbrëmje për mbrëmje këto grupe ngrinin këngën: nga Qafa e Kalasë, nga Bregu, nga Gorica, nga Bilça, nga Çezma e Kishës së Shëndëlliut, nga Hani i Mullait, nga Velabishti, brenda në qytet, si në kafe-ahengun e Shebibit, në kafenetë buzë Osumit...

Ka mbetur i përmendur përshkrimi i festës së terzinjve (robaqepësve) nga Nezim Berati në vitin 1732, në ditën e dhëniers së testireve (lejeve të profesionit). Nga vargjet e kësaj poezie mësojmë se veçori e ahengut beratas ishte karakteri i tij masiv. Kënga beratase këndohej në bashkësi dhe jo nga këngëtarë të veçantë.

Le të përmendim sa për ilustrim vetëm katër vargje nga kjo poezi:

"Një me këngë, një me saze,
të përzjerë me shumë naze.
Dhe pleqtë u bënë taze,
Në shenllëk zunë mejdan."

Këto grupe janë mbështetur në muzikantë dhe këngëtarë të njohur. Midis tyre po përmend: Poetin e njohur Nezim Berati, instrumentistët-

këngëtarë të mëvonshëm: Riza Nebati, Shyqyri Fuga, Shaje Llaka, Mini Osmanit, Qerim Fuga, Josif Skrami, Halit Haznedari, Tetem Suku, goricari Jorgji Bendi, Zihni Berati, Naxhi Berati (pa harruar edhe më të rinjtë: Asqeri Kadëna, Sotir Konçi, Xhevdet Dervishi, Virgjini Mile, Hyrie Saraçi, Rolanda Riko, Dhimitër e Kozma Dushi, Ajet Caushi, Floresha Debinja, Petrit Berisha, Naun Teta ...)

Nëpër këto ahengje janë ngritur këngët e njohura: "Një zog në sabah ç' më thirri", "Kur hyj në Mangalem", "Gjyla rrumbullak si veja", "Në Fushë të Uznovës", "Unë jam djalë e nuk jam plak", "Qerimeja çup' e parritur", "Në namaz kur falem", "Djersa jote ujë trënfafili", "O bilbil, o zogu i parë", si dhe shumë këngë që kanë zënë vend edhe në repertorin e grupit të ringritur të këngës qytetare beratase.

Ky grup shkon në këtë traditë. Këngëtarët-solistë, janë të shkrirë një me grupin, duke e ruajtur karakterin masiv të ahengut beratas.



Përgatitur nga Vlash Pambuku

Puna e këtij grupi është për t'u lavdëruar. Ishte puna e tyre, sakrificat, që e bindën edhe bashkinë që ta mbështesë duke i dhënë mundësinë e zgjerimit të tij për të fituar përmasat e përfaqësimit të këngës së Beratis. Është për t'u çmuar edhe ndihma që ka dhënë edhe biznesmeni beratas Pali Shkarpa.

Është prezantimi i këtij grupi në Tiranë para shoqatës Berati, që krijoi mundësinë edhe të prezantimit të librit "Këngët e Beratis", duke u bërë kështu një urëlidhëse e ngushtë e punës studimore me atë interpretuese.

Marrja e drejtimit të këtij grupi nga muzianti i njohur Fatbardh Dervishi pranuar me dashamirësi nga pjesëtarët e tij, ishte një hap i ri që shënoi rrugën e ngritjes së nivelit cilësor dhe artistike të interpretimit të këngës.

Ky grup, edhe pse në koncertet e dhëna ka bashkëpunuar me këngëtarët e njohura popullore beratase Virgjini Mile dhe Hyrie Saraçi, ka mbetur një grup burrash. Mbetet detyrë zgjerimi i tij me elementin femër, me këngëtarë të njohur dhe të rinj.

Me rastin e njëvjetorit të krijimit i urojmë mbarësi dhe suksese të mëtejshme!

Agim Mehqemeja

Grupi i këngës qytetare "Berati" në njëvjetorin e tij



Xhemalie Nova

Janë fjalë që më dalin thellë nga zemra. Janë fjalë që përshëndesin grupin e këngës popullore qytetare beratase me rastin e njëvjetorit të krijimit.

Ngritja e këtij grupi në nëntorin e vitit të kaluar

Leonidha Xhimitiku, Gaqi Samarxhiu, Emanuel Ndrio dhe pas një heshtjeje mbi një dhjetëvjeçar, e shohim të rizgjuar këtë traditë me nismëtarë: Stavri Bobo dhe Vlash Mile.

Sigurisht, në realizimin e këtij misioni fisnik, ata nuk ishin vetëm. Goricarët dhe disa këngëtarë e instrumentistë të lagjeve të tjera e mirëpritën ngritjen e këtij grupi dhe u aktivizuan në gjirin e tij me shumë dëshirë. Pjesëtarëve të grupit iu desh të luftonin me konceptet penguese që shfaqeshin aty-këtu, në forma të ndryshme, si: "grupit i mungojnë

mbështetës.

Kujtoj, me këtë rast, djalin nga Kalaja Pal Shkarpa, që me dëshirë dhe zemërgjerësi, duke hequr nga fitimet e biznesit të tij, po e mbështet financiarisht veprimtarinë e këtij grupi. Gjithashtu shpreh konsideratat e mia për djalin e lagjes së Vakëfit, Bujar Lybesha, për mbështetjen që i ka dhënë në fillimet e tij këtij grupi.

Grupi tashmë është vetëm një vjeç. Megjithatë ai i ka rritur ndjeshëm treguesit cilësorë. Kjo e ka burimin te këmbëngulja e të gjithë pjesëtarëve të grupit, te puna me përkushtim e udhëheqësit



Grupi artistik "Berati"

tregoi se filluam t'i bëjmë një mjekim plagës që na ka gërryer. Sot që grupin e kemi të ngritur, ka nisur etapa e ripërtëritjes së traditës, kur e kishim ansamblin e këngës popullore beratase me këngëtarë e njohur: Zihni Berati, Virgjini Mile, Hyrie Saraçi, Dhimitër Dushi, Kujtim Babunja, Floresha Debinja, Ajet Caushi, Ludmilla Baballëku, Naun Teta, Rolanda Riko dhe me drejtuesit e talentuar Sotir Konçi dhe Asqeri Kadëna. Ne, "qejflinjët e Beratis", kemi ditur ta ngrejme dhe ta duam këngënn tonë popullore.

këngëtarët e mirëfilltë, ai nuk mund të ketë cilësi, nuk ka si të ketë vazhdimësi..." Pavarësisht nga këto, nismëtarët dhe ata që e mbështetën, nuk u tërhoqën. Luftuan dhe fituan. Grupin sot e kemi të ngritur. Dhe grupi e nisi jetën artistike, me ata beratas që i bashkon dashuria, pasioni dhe përkushtimi për ta kënduar me shpirt këngën popullore të qytetit të tyre. Kam ndjekur dy shfaqje të këtij grupi.

Kur salla u elektrizua, pashë të moshuar që këndonin me lot në sy. Ndërkohë edhe unë nuk durova, shpërtheva,

artistik Fatbardh Dervishi, tek udhëheqësi administrativ Stavri Bobo dhe presidenti Pali Shkarpa.

Kjo është rruga premtuese dhe e mbarë e këtij grupi. I uroj jetë të gjatë dhe suksese gjithmonë në rritje!

Dua të theksoj një falë të fundit zemre. E dua Beratin me gjithë shpirt. Pa dyshim, si unë, e do Beratin çdo qytetar i tij. Prandaj u bëj thirrje të gjithë beratasve, kudo që të ndodhen: ju lutem, sipas mundësive, jepni ndihmesën tuaj që qytetit tonë t'i kthejmë buzëqeshjen, humorin, këngën, artin, shpirtin e gjithçka të mirë e



Pjesëmarrës në shfaqjen e grupit artistik "Berati"

Zanafilla e këtij grupi, të cilit sot po i kremtojmë njëvjetorin e lindjes, i ka rrënjët në traditat e hershme të goricarëve, që e kanë kënduar këngën beratase:

këndova dhe kërcëva në sallë. Ishte një atmosferë tepër mbresëlënëse. Tashmë jehona e grupit është përhapur.

Ai ka gjetur dhe po gjen

të bukur që ai ka ruajtur! Ju lutem, mos harroni, është qyteti juaj!

Xhemalie Nova
Ish- kërcimtare e grupit artistik "Berati"

Plak ashik edhe topall



Vasillaq Kumani

Tregim

Ecte xha Pilua përpjetë rrugës me kalldrëm duke u mbështetur mirë në bastunin e tij me atë dorezën e drunjte ku ishte gdhendur një kokë e vockël gruaje me buzët e zgjatura e të puthitura gati për puthje gjithë zjarr.

Oh, sa e mundonte ajo këmba pak më e shkurtër nga tjetra! Ai picëronte sytë në atë natë të vonë për të dalluar pak më mirë gurët e rrafshhtë që të mbështeste bastunin për të mos i rrëshqitur. Retë shty-heshin drejt jugut dhe hëna, që dilte nëpër të çarat e reve, duket se lëvizte drejt lindjes dhe prapë qëndronte në vend duke hedhur mbi gurët e lëmuar nga koha njolla drite.

Ja, më në fund e kaloi atë copë rruge të përpjetë dhe u fut në rrugicën e tij që merrte një zbritje të lehtë. Muret e shtëpive, që ngriheshin në të dy anët dhe e mbanin rrugicën si të shtrënguar midis tyre, ia vështrësonin edhe më tepër vështrimin. Ai u shmang pak nga e djathta dhe filloi të ecë fare afër murit nën strehën e një çatije. Në cast, rruga u vesh me dritë hëne, u ngjit nëpër mure dhe xha Pilua qëndroi i mbërthyer në vend.

Ç'ishte kjo hije që i doli përpara?

U afrua pak, edhe pak, dhe ja, i dalloi. Ishin dy trupa ngjeshur pas murit. Rreth qafës së djalit ishin shtrënguar dy duar, fytyra e djalit kalonte herë majtas e herë djathtas, por buzët qëndronin gjithnjë të puqura, si të ishin ngjitur njëra me tjetrën.

Xha Pilua qëndroi edhe ca pa lëvizur, pastaj nxori një zë që kullonte vetëm dhembshuri.

-Po është vonë, more të bekuar, është vonë, ju s'e kuptoni, por po afron mezi i natës, pastaj është edhe kaq ftohtë, kaq ftohtë. Aman, më dëgjoni mua, do merrni plevitin!

Për ata të dy kjo botë ishte inekzistente, ishin vetëm ata dhe askush tjetër. Fjalët e xha Pilos iu dukeshin si copa mbeturinash pa peshë, që binin nga një botë tjetër e hedhur në erë. Xha Pilua provoi edhe një herë:

-Po amani, o të bekuar, amani, do merrni plevitin!

Asnjë përgjigje.

Xha Pilua u tërhoq ngadalë pa dashur t'i shqetësojë më. Ashtu, duke

çaluar e mbështetur te bastuni, kaloi edhe atë copë rrugë deri te porta e tij. Kapërceu pragun, i vuri panxhën portës dhe filloi të ngjiste shkallët prej dërrase.

- Po ç'u bëre, o Pilo, ç'u bëre,- bërtiti Dhoksa në krye të shkallëve,- ç'u bëre!

Pilua gojë kyçur ngjiti shkallët, kapërceu divananin, u fut në dhomën e gjumit dhe drejtë e te dritarja që binte nga rruga.

-Na, ku vete! - thirri Dhoksa.

-Hajde, hajde, shiko atje, atje poshtë nën strehën e murit të Kozit!

Dhoksa ngjiti ballin te qelqi i dritares.

-Nuk shikoj gjë unë.

-Po si nuk shikon, moj, - ia pat Pilua, - një çift, një çift, ja, atje! - dhe drejtoi gishtin.

-U pu pu pu,- përplasi pëllëmbët Dhoksa - e paskan lënë mend të ziun Pilo, hajde ore të flemë, se vajti njëmbëdhjetë e natës!- dhe e tërhoqi zvarrë.

-Po janë të rinj, moj Dhoksë dhe është palca e dimrit, do sëmuren.

-Nuk i paska zënë flama! Hajde, të thashë!- dhe bëri ç'bëri e zhveshi dhe e shtriti në dyshek, duke e mbuluar me një flokje të trashë dhe sipër saj velenxën.

-Hajde, fli tani!

Po xha Pilos nuk i mbylleshin që nuk i mbylleshin sytë. Priti sa Dhoksën ta zinte gjumi, hoqi ngadalë mbulesat dhe ashtu, çalë -çalë, shkoi te dritarja. Shiu i imët që kishte filluar, ia turbullonte dhe më tepër vështrimin. Hapi pak kanatën, një shkullmë thellimi i acartë ia përthau fytyrën, në tërë trupin ndjeu një drithërimë dhe çapoku filloi t'i therte prapë sikur ta grryejë me hekur të skuqur.

Zgjati pak kokën dhe përmes asaj perdeje të hollë shiu iu bë se dalloi hijen që qëndronte ngjeshur pas murit të Kozit.

-Eh! - i shpëtoi një e hequr si ofshamë,- do sëmuren, do sëmuren!

Ktheu kokën nga Dhoksa. Ajo si ato macet që rrotullojnë kokën dhe e ngjeshin pas bishtit, po gërriste për shtatë palë qejfe. Xha Pilua u ngrit dhe doli në divanan, mori fenerin, e ndezi dhe zbriti shkallët. Në fund të shkallëve hapi një derë që të çonte në katua, ngriti pak fenerin, në fund të katoit, varur në një gozhdë pa gunën e dhirtë që e hidhte krahëve i jati kur nxirrte dhitë për kullotë. Ashtu, në njërin dorë gunën e në tjetrën fenerin, ngriti me sup panxhën që mbante të mbyllur portën dhe kapërceu pragun, iu afrua fare pranë. La fenerin nën strehë dhe pa thënë asnjë fjalë, i hodhi djaloshtit krahëve gunën e rëndë duke u kujdesur t'ia mbështillte mirë supet dhe qafën që mbahej akoma rrethuar nga duart e vajzës.

-Tani rrini sa të doni-tha me vete, mori fenerin dhe nisi të largohej.

-Hyskë, ndjen të ftohtë?- dëgjoi zërin përkëdhelës të vajzës.

-Të ftohtë? Jo, një ngrohtësi dhe një si peshë mbi shpatulla.

Xha Pilua ngjiti shkallët, shoi fenerin tek ai korridor i vogël dhe vajti prapë te dritarja, u ul këmbëkryq dhe mbështeti mjekrën te pragu i dritares, hodhi sytë përjashta. Napa e zezë e natës mbështillte gjithçka. Tani as çatitë nuk dukeshin, por mendja i nxirrte përpara gunën e dhirtë që mbante djaloshi dhe ia ngrohte shpatullat.

"Eh, ku je, moj rini, ku je, si më ike kaq pa prituri! Dhe kujtimet, si mëzenjtë e hazdisur, u sulën drejt atyre kohërave të largëta duke shkundur ngjarje të dëgjua dhe të jetuara.

Ja, kafeneja e Shebibit. Nga një kthinë e kafenesë, që ndahej prej një perdeje të hollë, del papritur Difja. Hyn Difja me defin në dorën e ngritur dhe e tund duke bërë xhinglat të dridhen, gishtin e madh të dorës tjetër e rrëshqet rrotull deficit. Kafeneja mbushet si me trokun e kuajve dhe nga jelet e tyre që hidheshin sa andej- këtej shkudeshin tinguj gazmorë zilësh dhe pastaj kënga.

Difja rrëshqet nga tavolina në tavolinë dhe në fund ulet pak, fare pak, te Nani. Kur këndonte Difja, të fërgëllonte shpirti e të ngriheshin flokët e kokës përjetë. Nani nuk mbahej më, mbushte grushtin me florinj dhe e godiste me 'to në gjoks, në kokë, në këmbët, ku ta zinin. Një herë i hodhi supeve një si pelerinë të qepur me napolona letër. Ajo dridhej e përdridhej, Nani shkulte flokët dhe lotët si ruaza i binin faqeve.

Rakija të merr mendtë e kokës, por t'i jep prapë, po ky drej merak të merr mendjen e gjënë e s't'i kthen më. Aty te Difja iu tret malli Nani, aty zbrazeshin dertet, merrnin udhë këmbët.

Nani mori krrabën,

Difja mori fyellin.

Bagëti e Nani,

mori përpjetë pyllin.

Pastaj ishte dhe ajo qëne malazeske. E bukur te Zoti. Thoshin e ç'nuk thoshin. Thoshin se perëndia e kishte braktisur botën në hallet e saj dhe kishte qëndisur malazeskën. Apo s'kishte një zë! Aty gdiheshia unë aty gdiheshi dhe Foti. Ajo këndonte në gjuhën e saj dhe ne s'kuptonim asnjë fjalë, por e ndjenim së thelli përse bëhej fjalë, e kuptonim nga sytë e malazeskës kur derdhnin atë dritë mallëngjimi, nga lotët që i këputeshin, nga duart që i dridheshin. Ja, me siguri, kënga tregonte për një djalë që shokët i bënë shaka dhe i thanë se e dashura e tij kishte varur një gur në qafë dhe ishte mbytur në lumë vetëm se prindërit donin ta martonin me një tjetër. Djali nxori koburen dhe bëri një brimë të vockël në

ballë. Malazeska kalonte gishtat nëpër flokë, i krihte apo i shkulte? Foti u mbyt në lot, u ngrit vrikthi në këmbë dhe sokëlliu: "koburen Shebib, koburen!"

Ja, këto ngjarje i kalonin nëpër mend xha Pilos. Kapakët e syve po i rëndoheshin, u përpoq të kujtonte se çfarë i ndodhi më vonë Fotit, por në kokë tani kishte një si turbullirë dhe të tjera pamje po i dilnin: çfarë ishin këta kuaj korb të zinj që bridhnin korijeve? Ja, tani e ndalën vrapin, duken të lodhur, u mbytën ata në mes të fluturave, flutura të bardha, të bardha dhe sa një pëllëmbë.

"Oh,- mendonte turbull Pilo Shtëmbari,- paska dhe flutura të bardha? Jo, jo, qenkan flokë dëbore, fushë e bardhë, male të bardhë. - E...,- mendoi prapë,- ç'po ndodh me mua? Mos po më vjen ajo qëne?"

Dhoksa u zgjua dhe zgjati dorën drejt Pilos me merakun se mos është zbuluar. Nuk e gjeti aty. U ngrit përgjysmë dhe bërtiti e lebetitur, kur pa Pilon mbështetur te dritarja.

Pilua sikur u zgjua nga një ëndërr.

-Hë!- dhe ktheu kokën nga Dhoksa, - ç'ke?

- Upupu, more Pilo, ç'të gjeti kështu, ç'të gjeti?- dhe sa kaq e drejt e te Pilua. U përpoq ta tërhoqte.

-Dale, - tha Pilua, dhe hodhi vështrimin përtej dritares. Agu i ditës po thithte brenda vetes terrin e asaj nate kalkan. Pa vetëm gunën lëshuar për tokë si ndonjë kacak i çfryrë. - Guna, Dhoksë, guna, ec e ma merr, merre, kam ftohtë Dhoksi.

- Na marrtë të keqen guna, hajde se të mbuloje me flokjen!

-Jo, Dhoksë, jo, ec e ma merr, merre e ma hidh shpatullave, ajo më mban ngrohtë, pastaj flokjen, pastaj. -Pilo...! lëre gunën dhe hajde!

Pilua u përpoq të ngrihej, por këmbët s'e mbajtën dhe ra prapë ashtu siç ishte.

-Ik, Dhoksi, ik, mos më bëj mua të tërhoqem zvarrë!

-Kokë shkëmb!- bërtiti e shoqja në kulmin e zemërimit dhe ashtu siç ishte brodhi drejt derës, zbriti shkallët dhe u gjend te porta e hapur. Il shuari,- mallkoi, - edhe potën e paska lënë hapur!

Kaloi atë copë rrugë mori gunën dhe ashtu me një frymë ngjiti shkallët. Kur arriti te dera e dhomës, lëshoi një britmë:

-Pilo, e zeza unë!

Pilua me këmbët përthyer, kishte rënë në një krah mbështetur pas murit.

-E zeza unë, Pilo!

Ajo filloi ta tundte:- Ç'ke, Pilo, ç'ke, më thuaj një fjalë! Sytë gjysmë të hapur të Pilos qëndronin mbërthyer në një pikë. Ata dukeshin si dy gropa të zeza, sy të shuar, të finjosur.

Dhoksia e tundi edhe një herë dhe pastaj brodhi nga dritarja e divananës që binte në oborrin e komshisë dhe lëshoi mënyrën që e gjeti:

-Thinë, moj Thinë! E zeza unë, kam keq Pilon!

Çatisën komshijtë. Ngjelina erdhi me një frymë e drejt e te Pilua, i ngriti edhe pak kapakët e syve dhe pastaj tha:

-Më bini shpejt një qiri të ndezur.

-Unë s'di ku kam kokën,- tha Dhoksa.- Thinë, shiko ti, të keqen moj, amani moj!

Nuk vonoi dhe në dorën e Ngjelinës u gjend qiriri i ndezur. Ajo e ngriti pak kokën dhe mbajti qiririn drejt e përmbi mjekër, e mbajti ashtu një copë herë dhe pastaj, qetësisht, sikur t'i thoshte Dhoksës për një gjë fare të zakonshme, i tha: -E po... shëndosh ç'ka lënë mbrapa!

Dhoksia u këput mbi Pilon.

-Hë, mbaje veten- e shkundi Ngjelina,- apo do të turpërohesh! Duhet zhveshur e duhet veshur, se po u ftoh, të mbeti me këto rroba.- Hë, ju, - iu kthye të tjerave,- merrni me këtë punë, se unë ika, kam nusen e Thomait për të lindur, - dhe doli nga dera.

U bënë të gjitha gati, u gjetën edhe një palë këpucë të mira, të mbajtura, po çka të mira.

U shtri Pilua në mes të dhomës përmbi një dyshek të ri, pëllëmbët e duarve palosur mbi njëra -tjetrën dhe ngecur në të një tufë jasemine.

Dhoksia qante me oi.

-Plak i mirë xha Pilua,- hapi gojën njëra.

-Ashtu vërtet, shumë i mirë, apo nuk është i begenisur.

-I begenisur sa s'ka, - tha një nuse. -Kur të shikonte që isha para tij, të thërriste: " Dale, moj, dale, dale, se nuk të arrij dot" dhe hidhte me të shpejtë atë këmbën e shkurtër, të pyeste për shëndetin, të pyeste me radhë me radhë për të gjithë dhe në fund, të vinte në dorë një degë jasemine, nuk i ndante ato të shkreta.

Kishte kaluar një goxha kohë kur dha ballë Ngjelina.

-E moj Ngjelinë, - e pyeti Sofa,- lindi nusja?

-Lindi, lindi një goxha mashkull dhe fare kollaj.

Ajo u shty përpara dhe kur pa xha Pilon të shtritur, iu turr si e çakërdisur Dhoksës, e tërhoqi pak mënjandë dhe iu shkreh: - Turp të të vij, turp! Po nuk gjete dot një kuvertë të mbuloje gunën e dhirtë?!

-Aman, moj Ngjelinë, aman,- përgjerohej Dhoksa,- po ma la amanet, moj, ma la amanet, vetëm guna e dhirtë m'i mban shpatullat ngrohtë, guna e dhirtë!

Dhe iku xha Pilua në botën tjetër së bashku me atë gunën e dhirtë që mbante erë të dashuruarish.

Ishte koha kur varrezat e vjetra duhej të shpërnguleshin për një vend tjetër dhe Petroja vajti të

gjej varrin e gjysmesh. Ecte ngadalë largonte ferrat, shtypte me këmbë barin e rritur dhe ndalte herë pas here për të lexuar emrat. Kosta... lindur vdekur; Fani, Llaqi. I doli përpara një varr gjysmë i përmbysur, mbi të një kryq me një krah të thyer. Sipërfaqja e varrit ishte shtruar me rrasa guri si prej shtufe të lidhura me llaç cimentoje. Petroja lexoi me vështirësi emrin: Pilo Shtëmbari, 1858-1950. Mirë paska jetuar, mendoi, nëntëdhjetë e dy vjeç. Mori të ikë, kur i vajtën sytë te ca shkronja si të gdhendura me gozhdë mbi pllakën e gurtë. Eh, tha me vete, po këto? Deri në atë kohë nuk kishte parë mbishkrim të tillë përmbi varre. U kthye, fshiu me dorë pllakën dhe lexoi:

"Nдалu, moj, të them një fjalë, ndalu pak, ndalu, moj, se jam ashik, jam topall,

po jam dhe plak. Krejt pa prituri iu zbras një e qeshur kaq e fortë sa gjithë të tjerët, në kërkim të njerëzve të tyre, kthyen kokën. Ajo dhembje që qëndronte pezull mbi ata varre sikur e mallkonte dhe e sikteriste atë të qeshur prej të marri. U përpoq të gëlltiste brenda vetes atë të qeshur, por zorrët po i tundeshin dhe ai përpiquej t'i mbante duke shtrënguar duart pas belit. Ai ndjeu peshën e rëndë të atyre vështrimeve therëse, që ishin përplasur mbi të, dhe mori të largohej pa kërkuar më varrin e gjysmesh.

Ecte ngadalë dhe mendja i rrinte gjithnjë tek ai mbishkrim.. Ku i kam dëgjuar, i kam dëgjuar apo lexuar, ku? Përpiquej dhe prapë nuk e gjente dot. Por çudia më e madhe për të ishte, përse këto vargje mbi varrin e Pilo Shtëmbarit? Ç'lidhje kishte ky Pilo me këto vargje? Çfarë historie fshihej mbas këtij mbishkrimi?

Rodhën shumë e shumë vite dhe më në fund copa ngjarësh si ato rrëkezat që zbresin gëzueshëm për të takuar me simotrat e tyre në një shtrat të vetëm, erdhi e u formua e plotë jeta e Pilo Shtëmbarit .

Rasti e solli që Petrua të takohej me atë që dikur tetëmbëdhjetë vjeç djalë (sot shtatëdhjetë e kusur vjeç), ta gdhinte nën strehën e asaj çatije që i mori jetën xha Pilos.

-Nga të gjitha këto që thua ti, - filloi të tregojë plaku Hyskë, - unë di vetëm këtë: atë natë, një zë ëndre erdhi e më preku veshët si krahët e një fluturë: "Po amani, ore, amani, do merrni veten më qafë, do merrni plevitin!". Ja kaq.. Hë se harrova, ndaj të gdhirë ndjeva se më rrëshqiti nga supet një gunë, gunë e dhirtë. E shtyta me këmbë dhe ikëm të dy për t'u takuar sërish të nesërmen. Hë, ik tani,- tha i nervozuar.

-Dhe Petrua u largua për ta hedhur të gjithë këtë histori në letër.

Vasillaq Kumani

Puna më mban gjallë

Me 100 vjeçarin nga Drenovica e Beratit Riza Tafil Hasko

Drenovica e Beratit është një fshat fushor që kufizohet me fshatin Sukë të Fierit, Kutallinë, Samaticën e Goriçanin. Nga ky fshat ndodhet dhe personazhi i shkrimit tonë Riza Tafil Hasko, burri më i moshuar i Komunës së Kutallisë. Sipas regjistratit të gjendjes civile të Komunës datëlindja e tij datonte më 10. 03.1903, por vetë personazhi i shkrimit vërteton të kundërtën. Ju falenderoj që më erdhët në shtëpi dhe më pyesni për shëndetin dhe moshën- thotë xha Rizai, por datëlindja ime është diçka më tepër. Unë - thekson në bisedën e tij ai me datëlindjen e nënës jam 107 vjeç, kurse regjistrat janë djegur disa herë dhe nuk tregojnë të vërtetën. Për moshën e tij tregojnë dhe më të moshuarit, si Aqif Haxhi Beqiraj, nga Samatica, 87 vjeç, Muço Çala nga Goriçani 96 vjeç etj. Vetë xha Rizai e vërteton në këtë mënyrë datëlindjen e tij. Familja jonë ka ardhur nga Rasa e Elbasanit, sepse atje kishte kushte të vështira jetese. Babai ka ardhur kurse unë kam lindur këtu. Por dhe këtu nuk kishte tokë për t'u ushqyer, sepse ajo me bollëk ishte për të pasurit. E vetmja pasuri që kishim ishin dy qe me të cilën lëronim arën. Kur është ngritur Flamuri në Vlorë nga Ismail Bej Vlora, unë kam qenë 16 vjeç e lëroja arën. Ajo pëllëmbë tokë që kishim nuk mjaftonte, sepse gjithë sipërfaqja e tokës ishte e zënë me ujë e zhuka. I detyruar nga halli babai më sistemoi në një mulli e dyqan bashkë që e kishte një i pasur këtu në fshatin tonë.

Por dhe këtu nuk qëndrova shumë dhe u



Riza Tafil Hasko

largova me shpresën për të gjetur ndonjë punë tjetër. Babai erdhi për më mirë në këtë fshat, por u qa nga shiu e ra në breshër. Ishim fukarenj sa nuk të jepte njeri nuse, sepse mblesëritat në atë kohë bëheshin me para. Sado që babai im punonte shumë, nuk përballonim dot jetën. Ai jetoi 120 vjet dhe nuk e gjeti gjë nga puna. Atij vdekja i erdhi nga Zoti. Nga puna nuk të vjen vdekja kurrë, kurse papunësia të plak para kohe. Kështu u them dhe djemve. Nga që nuk kishim, u martova në moshë të madhe rreth 40 vjeç, dhe babai im i dha vjehrrit kaun e arës. E doja shumë nusen time Hankon, por më erdhi jashtëzakonisht keq kur ajo u mbyt në kanal, ndërsa lante rroba. Kur e mora vesh lajmin e zi përplasa duart pas kokës, por më foli babai duke më thënë se do të jap kaun tjetër për të gjetur nuse. Babai e mbajti, fjalën dhe kështu unë u martova duke i dhënë kaun tjetër vjehrrit (përmend emrin). Ishte viti 1943 kur mora gruan e dytë, aty nga muaji korrik. Pas një

muaji e gjysëm plasi lufta në Qafën e Sqepurit. I huaji nuk durohet, por dhe tek i huaji nuk rrihet. Kam qenë ushtar në Artë të Greqisë dhe dita më dukej muaj. Shkuam shumë shokë, por një pjesë vdiqën rrugës. Kështu ishte atëherë, cili pushtues të vinte, të përdorte si mallin e tij. Prandaj, sikur pak bukë të hash në vendin tënd, ajo të bëhet jetë e shëndet, kafshata e tjetrit nuk kapërdihet. Më dridhet trupi kur dëgjoj këngët e kurbetit. Nuk duhet t'i lëmë djemtë që të bëhen shërbëtorë të botës. Shqipëria nga dita në ditë po plakët, sepse këtu kemi mbetur ne pleqtë e plakët. Fëmijët duhet të punojnë në vendin e tyre që t'i kemi pranë në të mira e të këqija. Kam punuar tërë kohën, punëtor krahu në kooperativë e nuk më ka gjetur gjë. Ja, dhe tani dal që në mëngjes nga shtëpia dhe gjej punë përditë. Nuk më rrihet. Kur nuk punoj më prihen gjunjët, me punë kaloj ditën. Por kam dhe oreks të mirë. Në orën 4 të mëngjesit ha. Nuk pi asnjë lloj alkooli. Duhan po ashtu. Ha disa herë në ditë dhe pëlqej çdo lloj gjelle. Pëlqej perimet, djathin me domate, vezët të gjalla deri në 5 kokrra në ditë.

Ujin e pi me sheqer. Sa herë që më merr etja pi nga kjo pagure që e mbaj me vete. Nuk pres që të m'i bien gjërat, po i kërkoj vetë, megjithëse nuk më mungon shërbimi i nuseve dhe i djemve. Nuk kam parë sëmundje në trup dhe gjilpëra nuk kam bërë në jetën time.

Megjithëse i moshuar, përsëri jeta qenka e dhimbsur, sepse jepet vetëm një herë.

Nezir Vrapit

Kuzhinieri që ka ushqyer Presidentët

Pasi ka bredhëruar për 45 vjet me radhë në të gjithë vendet e botës që nga India, Kina e largët, Australia, Nju Jorku i zhurmshtëm, Afrika e Jugut me misterin e saj admirues Kalkutë e Bombei që të kujtojnë njëkohësisht Nënë Terezën, pa harruar edhe kryeqytetin e botës Parisin, për të mos folur për dhjetëra qytete e shtete me gjithfarë flamujsh e zakonesh, Franko Lafuenti para disa ditësh do të shkelte për disa ditë në qytetin e Beratit. Vinte për herë të parë këtu, pasi ka hedhur pas krahëve 73 vite jete aq sa është moshë e shumë presidenteve të disa vendeve të botës. I sigurtë se ky nuk është stacioni i fundit i profesionit të tij kaq interesant e të domosdoshëm për të gjitha moshat, shtetet, për të gjithë pozitëmbajtësit e karrigeve e te poltronave të rëndë.

Ishte kuzhinieri që shoqëronte grupin e madh të biznesmenëve italianë nga Brindizi në kuadrin e një panairi ekonomik e artistik si e quajten njëzëri pjesëmarrësit projektin italo-shqiptar "Skënderbeg-Expoberat", që u bë në mjediset e Galerisë "E. Lear" të qytetit nga datat 1-3 nëntor 2003, për të gjetur mundësi të kordinimit e të reklamimit ekonomik

Maestro Frankoja nuk bënte pjesë në presidiumin e kësaj veprimtarie, i cili i bënte edhe më shumë nder Presidentëve të Dhomave të Tregtisë së Brindizit e atij të Beratit, respektivisht Gianpietro Penneta e Petraq Picinane, të z. Tomor Rehovica aq i papërtuar që veprimtaria të dilte sa më mirë, të biznesmenëve nga Vlora, të bashkiakëve....

Ai ishte rreshtuar në llogoren e tij, si e quante me shaka, kuzhinën lëvizëse të ardhur posaçërisht nga Brindizi me të gjitha enët e, natyrisht, edhe me gatimin karakteristik të italianëve, siç janë makaronat e shijshme. Në të gjitha ditët e këtij panairi, mjeshtri italian gatoi e i serviri gjellë e verëra të rralla italiane të gjithë pjesëmarrësve. Një burrë trupshkurtër, me rroba mjaft të pastra, duke nisur nga këpucët që shkëlqenin nga pastërtia e lyerja, me atë humor karakteristik e tepër komunikues që në çastin e parë të bënte për vete.

Në gjoksin e tij të binte në sy një emblemë e veçantë. Më saktë është një medalion që në Itali e marrin ata kuzhinierë që kanë shërbyer mbi 20 vjet në sektorin

publik. Por, po qe se e nje nga afër jetën e tij, do të shohësh se këtu ka një "gabim" të vogël. Në gjoksin e tij duhet të kishte jo një, por disa medalione të tillë, ka shërbyer për 45 vjet si mjeshtër i kuzhinës, prej tyre 14 vjet i ka kaluar në marinën civile duke udhëtuar në të gjithë botën. Tani është profesor i gatimit në Shkollën A. Belgera të Brindizit që, si thotë ai, nuk do që ta ndërrojë me qytete të tjera. E ka të vështirë që të numërojë të gjithë njerëzit e shquar që ka ushqyer më gjellët e tij, veç të parët që i vijnë në mend janë Presidenti Italian Françesko Kosiga e Presidenti i Shqipërisë Alfred Moisiu. Një saktësisht po aq sa edhe kuzhinën italiane edhe kuzhinën indiane, australiane, franceze, spanjolle etj. Për



Franko Lafuenti

kuzhinën shqiptare nuk ka shumë njohje, megjithëse ka dëshirë që ta njohë sa më parë. Kur e pyesim nëse dëshiron që të jetë një ditë mësues në një shkollë të tillë shqiptare ngurron pak e thote se duhet që të jetë më parë nxënës i kësaj kuzhine.

Me krenari thotë se ka tri vajza e një djalë. I pëlqen pa masë Berati për aq sa e ka parë e është i gëzuar për miqtë e rinj që zuri në këtë qytet. Ka ardhur një moshë për Mjeshterin Franko që ai jeton fort me profesionin e tij si pasion i përrjetshëm. E kur e pyesim se kur do ta lërë këtë punë që duket se nuk e ka lodhur aspak, ai të thotë me seriozitet: "Do të punoj derisa Zoti të më japë shëndetin!"

Faleminderit, mjeshtri Franko!

Namik Selmani

Fabrika e prodhimit të bojërave dhe llaqeve



Alba-Color.Sh.p.k.

Bojërat më të mira me teknologji amerikane do t'i gjeni tek Alba-Color.sh.p.k, ku zbatohet sistemi i cilësisë ISO 9001. Tek ne do të gjeni një gamë të gjerë bojërash, plastike, akrilike, astarëve, bojëra vaji dhe zmalto dhe llaqe të ndryshme, izolues tarracash, bojë rrugësh (traffik paint)

Adresa: Tek ish -uzina mekanike e tekstilit.

Tel-fax: 00355 32 33 922 Cel. 068 21 63 807 Cel. 068 23 73737

Mbresa nga një libër i vendlindjes



Viliam Shehu

Sapo më ra në dorë libri “Babë Dudë Karbunara” këtu në Modena të Italisë, ku jetoj e punoj prej disa vjetësh, ndjeva njëherësh ngazëllim e nostalgji. M’u duk se më kishte ardhur një copëz vendlindjeje. E lexova me një frymë. Përshtypjet u përpoqa t’i hedh në këtë shkrim...

Në hyrje të librit autori, Viktor Papa, shkruan: “... duke shpresuar se kështu do të kem përmbushur detyrimin ndaj atit tim dhe ndaj qytetit tim”.

Por ai me këtë monografi përmbush një detyrim më të gjerë se ndaj të atit, mësuesit të nderuar Vlash Papa dhe ndaj qytetit tonë të mrekullueshëm, Beratit. Me këtë libër ai plotëson gjithashtu një detyrim ndaj Historisë së Shqipërisë në përgjithësi dhe Historisë së Arsimit në veçanti, të cilat kanë shumë nevojë të zbardhërohen në këtë kohë.

Monografia “Babë Dudë Karbunara” është shkruar me një gjuhë të kuptueshme, të qartë, të rrjedhshme, të ëmbël dhe pa përdorur asnjë fjalë të huaj. Kjo ka ardhur për mendimin tim nga që autori jo vetëm se është njohës i mirë i gjuhës shqipe, por edhe nga dëshira dhe ndjenja e thellë e tij për t’ia paraqitur bashkëkohësve Babë Dudën ashtu siç ishte ai, një mësues i njerëzve të thjeshtë, një atdhetar i vërtetë në kohë shumë të vështira dhe delikate për fatin e atdheut, të bazuara të gjitha këto në burime të vërteta historike e as më pak e as më shumë. Libri është shkruar në mënyrë bindëse, i zhveshur nga frazeologjia boshe.


Është e vërtetë që Babë Duda jetoj dhe veproi në Berat, por puna e tij për mësimin e gjuhës shqipe, këmbëngulja e tij për hapjen e shkollave shqipe, kanë rëndësi të madhe jo vetëm për Beratin e krahinat rreth e qark, por për gjithë Shqipërinë.

Siç ndodh me monografi të kësaj natyre, qysh në kapitullin e parë, *Vitet e fëmijërisë dhe të rinisë*, autori na njuh me mjedisin ku lindi dhe u rrit Babë Dudë Karbunara. Faqe pas faqesh shpaloset historiku i ndërtimit të Beratit, të këtij monumenti shumë të lashtë si dhe jeta e gjallë e këtij qyteti gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX si qendër e rëndësishme e zhvillimit dhe e udhëkryq për gjithë Shqipërinë e Jugut.

Rëndësi të veçantë Viktor Papa i jep mjedisit kulturor ku u edukua Babë Dudë Karbunara. Berati, siç shkruan autori, ka qenë një vatrë e rëndësishme kulturore, me shkollë të shumta në qytet e në fshatrat përreth. Edhe pse këto shkollë ishin në gjuhën greke e turke, ato u jepnin mundësi të rinjve të mësonin shkencat, gjeografinë e historinë e në të njëjtën kohë u hapnin sytë që të kuptonin edhe nevojën për të mësuar në gjuhën e tyre.

Në libër paraqitet bukur dhe qartë zhvillimi i jetës sociale në qytetin e Beratit, ku myslimanë e të krishterë jetonin në harmoni të plotë dhe merakoseshin njëllot për fatet e qytetit të tyre dhe të gjuhës së tyre shqipe.

Autori na bën të ditur se në Berat gjatë viteve 1873-74 ka jetuar e punuar Naim Frashëri, po kështu më 1875 kanë ardhur këtu Kristoforidhi e Hasan Tahsini. Njohja e Babë Dudës me këta rilindës të shquar, siç thotë Viktor Papa, i dha zemër në punën për hapjen e shkollave shqipe e i dha zjarr atdhetarizmit të tij. Por edhe rilindësit ikën nga Berati më të qetë se lanë aty një bashkëpunëtor të denjë dhe të vendosur në përpjekjen për formimin e ndërgjegjes kombëtare te shqiptarët..



Në libër na jepet një panoramë e qartë e punës për përhapjen e ideve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në qytetin e Beratit, për pjesëmarrjen e patriotit të shquar Mehmet Ali Vrioni në Lidhjen e Prizrenit dhe formimin e degës së Lidhjes në Berat së bashku me figurën kryesore Babë Dudë Karbunarën. Aty përmenden dhe shumë atdhetarë të tjerë vendas, gjë që e bën edhe më të njohin më mirë historikun e qytetit të tyre.

Me realizëm dhe besnikëri autori përshkruan mjediset dhe kushtet e vështira, në të cilat punonin Babë Duda dhe shokët e tij për t’u mësuar bashkëqytetarëve të lexonin e të shkruanin shqipen, gjuhën e tyre. Periudha e fundit të shek. XIX dhe e fillimit të shek. XX e gjen Babë Dudë Karbunarën në qendër të të gjitha përpjekjeve për liri e pavarësi, për përhapjen e shkollave shqipe, për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare.

Autori i monografisë, Viktor Papa, këto ngjarje të mëdha për fatet e Shqipërisë na i paraqet aq realisht e bindshëm, sa që të duket sikur ka marrë pjesë vetë në to. Mësojmë aty hollësisht mbi Memorandumin e Sinjës, mbi

çetat patriotike të kësaj treve e rëndësinë e tyre historike jo vetëm për Beratin, por edhe për gjithë Shqipërinë si dhe shumë fakte të tjera që ndriçojnë historinë e Beratit.

Babë Duda tanimë ishte i njohur në të gjitha qendrat patriotike. Me interesimin e tij vinin në Berat libra shqip nga Bukureshti e nga vende të tjera. Ai ishte bërë figura më e dashur e bashkëqytetarëve, simbol i atdhetarizmit, i shkollës e i gjuhës shqipe që arrin kulmin, kur, si përfaqësues i popullit të Beratit, merr pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912, ku zgjidhet edhe anëtar i *Pleqësisë*.

Me t’u kthyer nga Vlora Babë Duda e vazhdon punën me më shumë pasion e entuziazëm si mësues dhe si organizator i përhapjes së shkollave shqipe. Por ky gëzim iu ndërpre më 1914 nga kryengritja e Haxhi Qamilit, që kërkonte ta kthente rrotën e historisë prapa. Rebelët kudo në Shqipërinë e Mesme dogjën shkollë e rrahën mësuesit. Kështu vepruan edhe me Babë Dudën e moshuar, që e torturuan për vdekje. Por nuk e thyen dot. Përsëri ai do të vijonte punën si mësues e luftëtar i fjalës së lirë me vendosmëri deri në fund, derisa vdiq më 17 dhjetor 1917.

Në një kapitull të veçantë autori nxjerr në dritë pikëpamjet pedagogjike të Babë Dudës, të cilat të bashkuara me mendimet e rilindësve të tjerë, formuan mendimin pedagogjik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Libri është i pajisur me shënime sqaruese shumë të vlefshme. Në fund gjejmë të botuar Ditarin e Babë Dudës, një dokument ky me mjaft vlerë, i cili është ruajtur me kujdes nga ati i autorit të librit, mësuesi i mrekullueshëm, Vlash Papa. Shumë qytetarë autokton beratas mund të gjejnë në të diçka nga rrënjët e familjeve të tyre.

Babë Duda la pas gjërat më të çmueshme, atdhetarizmin dhe frymën iluministe si dhe një varg bashkëpunëtorësh e nxënës që e vazhduan punën në gjurmët e tij. Midis tyre duhet përmendur Vlash Papa, ky pasues i Babë Dudës, që ishte një edukator dhe mësues i spikatur në Berat. Këto dy cilësi ishin shkrirë te personaliteti i tij në mënyrë të përsosur. Unë personalisht e kam patur mësues në klasën e pestë, në vitin shkollor 1945-46, kur isha 12 vjeç dhe e mbaj mend fare mirë, pasi ka lënë gjurmë të pashlyeshme në shpirtin tim. Njohuritë që mora në histori, gjeografi, gjeometri si dhe duke mësuar përmendësh shumë vjersha të Naimit, Çajupit e poetëve të tjerë të Rilindjes, mbetën të ngulitura në mendjen time dhe natyrshëm ndihmuan në formimin tim të mëvonshëm. Të gjithë nxënësit e klasës e respektonin dhe e donin. Po ashtu dhe mësuesi Vlasi i respektonte dhe i donte. Shkollë e vjetër e “Tregut”, që tani nuk është më si godinë, për ne ishte shumë e dashur dhe shkonim me dëshirë, se atje na priste mësuesi ynë i dashur. Unë e quaj fat që pata atë si mësues. Ai qe ashtu siç e përkufizon shkrimtari italian L. Settembrini: “Mësuesi është një person i shenjtë që të jep dituri, që është më e çmueshme se çdo pasuri...”. Të tillë pasardhës la Babë Duda Karbunara.

Viktor Papa me këtë monografi u jep brezave të sotëm mesazhin se puna fisnike e mësuesit kërkon përkushtim, sepse një Shqipëri e re fillon në bankat e shkollës.

Populli i Beratit e deshi me gjithë zemër Babë Dudë Karbunarën dhe e shprehu mirënjohjen e tij të thellë duke e quajtur *Babë*.

VILIAM SHEHU
Modena - ITALI

Në vend të një interviste

Një portret Emir Qafën



Emir Qafa

Për të ndjerin Emir Qafa, ish-sportist e trajner në klubet e futbollit "Tomori" dhe "5 shtatori", mësuesin e edukimit fizik, kam disa kujtime nga jeta disavjeçare sportive e tij. Ishte viti 2000. Biseda jonë u ngrit vetëm për sportin. Befas më lindi mendimi dhe i bëj Emirit kërkesë për një intervistë. E mirëpriti. Lamë një ditë të shkonim në Çorovodë. Atje, siç më thoshte Emiri, do të ishte më mirë, pasi do të dëgjoja të flisnin për ndihmesën time skraparllinjtë që më njohin mirë. Kam mall për ata njerëz bujar që ma hiqnin atë mërzë që më shkaktonte njolla në biografi. Kam kujtime nga Çorovoda piktoreske, nga Radëshi e Bogova ku kalova kohën me të gjatë të jetës.

Por dëshira e zjarrtë e tij dhe imja nuk u realizuan, megjithatë, vendin e intervistës e zuri portreti i tij për atë jetë sportive e kontribut që unë e njoh mirë.

Emiri sportist i gjithanshëm

Nëse do të përmendim emra sportistësh në Berat, që janë

aktivizuar në shumë sporte, Emiri është ndër të parët, sigurisht, këtu është fjala për sportist cilësorë që është aktivizuar dhe pati rezultate në veprimtari kombëtare.

Emiri i vogël, i shkathët, i shëndetshëm, muskuloz hidhej nga njëri sport në tjetrin: në futboll e volejboll, në basketboll e mundje, atletikë, boks, hendboll. Pati stazh të gjatë edhe si trajner në ekipin e futbollit "5 shtatori". Emiri dashuronte më shumë futbollin. Luajti me ekipin e të rinjve "Tomori", me "Dinamon" e Beratit dhe me "5 shtatorin" e Çorovodës. Fiziku, shtatlartësia dhe teknika e kishin bërë të suksesshëm si qendërmbrojtës.

Më i vogli i kampionatit

Ishte nxënës në shkollën e mesme pedagogjike në Berat



Viti 1956. Emiri (i pesti), trajner me ekipin "5 shtatori"

(1950) kur aktivizohet me ekipin e hendbollit "Tomori" në kampionatin kombëtar

Emiri u nderua me diplomë, e cila u vlerësua më shumë edhe për faktin se ishte sportisti më i vogël i kampionatit dhe si mbrojtës shënoi 3 gola, rast i veçantë për një mbrojtës.

Emiri ishte edhe një mundës dhe alpinist i mirë. Në kampionatin kombëtar të mundjes për të rinj në Shkodër zuri vendin e 3-të. Në kampionatin kombëtar të alpinizmit 1951 në Dajti Emiri ishte pjesëtar i ekipit "Tomori", që zunë vendin e dytë.

Atletika, pas futbollit

Emiri ishte atlet cilësor. Disa ditë para veprimtarisë kombëtare bënte stërvitje individuale pa trajner. Garat që konkuronte ishin vrapimet në distanca të gjata 3000 m, 5000 m, 10000 m dhe maratonë lokale dhe kombëtare. Në maratonë

nderi në garat hedhje gjyle dhe shtizë duke zënë vendin e parë në spartakiadën kombëtare të kategorisë së dytë.

Surpriza e Emirit

Emiri ushtronte edhe boksën.



Viti 1952, në kampionatin kombëtar të atletikës. Emiri (i treti), Stavër Ngofo, Marjanthi Nano

Më tregoi një ditë një takim sa interesante, aq edhe gazmore. Ngjarje që unë e quajta "Surpriza e Emirit". Ekipi i boksit "Tomori" mori pjesë në kampionatin kombëtar të boksit në vitin

1951 në Korçë. Trajneri i "Tomorit" ndërhyu pranë trajnerit të Tiranës që ketë kujdes Emirin, pasi ishte në moshë të vogël dhe del për herë të parë në ring. Trajneri tيرانas premtoi.

Në ring. Emiri ka

përballë kampionin. Nuk kaluan as 5 sekonda Emiri godet fort aq sa kampioni bie e shtrihet në ring. Ai nuk ngrihet edhe pas numërimit 10 të gjyqtarit, i cili shkon dhe i ngreh dorën Emirit

duke e shpallur fitues. Sportdashësit shpërthyen në brohoritje, disa prej tyre e ngritën në krahë Emirin, ndër ta ishte dhe profesori i matematikës i shkollës pedagogjike në Berat, korçari Theodor Qirici (Nokja).

Me dashurinë për njerëzit, punën

Ishin një kompleks cilësish të karakterit si njeri i besës, bujar e miqësor, me cilësi e vlera në qëndrimin ndaj punës e njerëzit, të cilat e kishin bërë Emirin njeri të nderuar dhe të respektuar.

Si mësues dhe njeri i sportit merakosej për ata nxënës që rrinin indiferentë ndaj sportit. Kishte kënaqësi që nxënësit të mos e donin sportin thjesht si tifozë, por të mereshin me të, ndaj në shkollë i aktivizonte, një pjesë e të cilëve përgatitej për në ekipet sportive. Në luftë me konceptet, në Çorovodë punoi për ngritjen e sporteve të reja të qitjes, peshëngritjes dhe ndërtoi terrene të thjeshta sportive.

Në vitet e demokracisë u nderua me titullin "Mësuesi i Merituar".

Intervistë para garës 30 metra



Koço: Do ta fitosh garën?

Iliri: Jo! Këta janë më të mëdhenj se unë

Përgatiti: Vlash Pambuku



Syri i Lajmëtarit

Tek Syri do të gjeni lajmërimet për shitje dhe blerje të objekteve të ndryshme si: dyqane, shtëpi banimi, troje, makina, elektroshtëpiake, kanceleri, mjete transporti etj. etj.

Suplementi Syri është një rast i mirë për të gjithë ju që do të shitni, për të gjithë ju që do të blini.

Adresat e sakta, numrat e telefonit, kontaktet, çmimet jua ofron Syri i Lajmëtarit të Beratit. Ai është syri juaj për të kapur rastin e mirë, për të shitur dhe për të blerë.

Qytetarë të Beratit! Afrohuni pranë Syrit të gazetës dhe ai do të jetë Syri juaj.